

1 E mërkurë, 18 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat përmbyllëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.01

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar,
7 mund të paraqisni lëndën.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 mirëmëngjesi. Kjo është çështja numër KSC-BC-2020-06,
10 Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
11 Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi.
13 Mirë se vini të gjithë. Vërej praninë e të gjithë të akuzuarve
14 në sallë të gjyqit sot.

15 Sot do vazhdojmë me deklaratat përmbyllëse në këtë
16 çështje. Do të dëgjojmë përgjigjen nga Mbrojtja e Viktimave.
17 Pastaj do të dëgjojmë komentet e Ekipeve të Mbrojtjes ndaj
18 parashtrimeve të ZPS-së, përgjigjeve të ZPS-së që dëgjuam të
19 hënën, dhe deklaratat e katër të akuzuarve sipas rregullës
20 135(4). Dhe, në fund, përveç në qoftë se ka ndonjë ka ndonjë
21 kundërshtim, do të vazhdojmë me mbylljen e kësaj çështjeje,
22 sipas rregullës 136.

23 Rendi i ditës për sot i vendosur sipas urdhrit të Trupit
24 Gjykes për fjalët përmbyllëse që është F03639. Aty janë
25 paraqitur rendi i ditës, megjithatë, meqenëse ZPS-ja mbylli

1 paraqitjen e provave të saj të hënën, nuk do të ketë nevojë që
2 të zgjasim seancën e ditës së sotme siç e kishim parashikuar
3 fillimisht në F03639. Seanca e sotme do të përfundojë jo më
4 vonë se në orën 16.45 minuta. Do bëjmë një pushim në orën
5 10.30, rreth 15 minuta, pastaj vijojmë në 10.45 dhe pastaj
6 gjysëm ore dhe pushimin e drekës në orën 1.00. Pasdite, do të
7 bëjmë ndoshta një pushim, në qoftë se është e nevojshme, për
8 të organizuar pjesën tjetër të ditës apo rendin e ditës.
9 Ndoshta mendoj se të akuzuarit deklaratat e tyre do t'i japin
10 pas pushimit të drekës që ndryshe të mos ndërpriten dhe të
11 kenë vëmendjen e të gjithëve.

12 Përpara se të fillojmë me deklaratat përmbyllëse, kemi
13 një çështje paraprake që Trupi Gjykses dëshiron të trajtojë
14 lidhur me riklasifikimin e transkriptit.

15 Trupi Gjykses vë në dukje se ka disa riklasifikime të
16 transkriptit, kërkesa për riklasifikim për të cilat Trupi
17 Gjykses duhet të vendosë. Trupi Gjykses kërkon të dëgjojë
18 palët, dëshiron të dëgjojë palët dhe pjesëmarrësit nëse ka
19 ndonjë kundërshtim për mbylljen e kësaj çështjeje ndërkohë që
20 kërkesat për riklasifikim janë duke u trajtuar.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Do veprojmë në këtë mënyrë atëherë.

3 Me këtë përmyllën komentet e Trupit Gjykses. Kërkesat
4 për riklasifikim të transkriptit do të trajtohen në kohë të
5 duhur.

6 Do fillojmë tani me deklaratën e Mbrojtësit të Viktimave.

7 Z. Laws keni rreth 15 minuta. Vazhdoni.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

9 Së pari, sot do të trajtojë disa pika që u ngritën nga
10 Mbrojtja e Selimit. Dhe pastaj disa nga pikat që u ngritën nga
11 Mbrojtja e Krasniqit të hënën.

12 Pikat e para, aspektet e para që dua të trajtoj janë
13 çështja e shkakut, shkakësisë dhe rolit të Mbrojtësit të
14 Viktimave lidhur me të.

15 Ne kemi dy diapozitiva që do të na ndihmojnë sot në
16 mëngjes për këtë çështje, dhe me ndihmën e Sekretarit të
17 Gjykatës do të kërkoj që të shfaqet i pari në ekran. Të tre
18 këta diapozitiva mund transmetohen për publikun. Faleminderit.
19 Mund të kalojmë tek diapozitivi i dytë, ju lutem.

20 Në krye të faqes kemi një ekstrakt nga transkripti, faqja
21 28908, nga parashtrimet e Selimit të premtën e kaluar:

22 "Parashtrimi i Mbrojtjes së Viktimave mbështetet
23 gjithashtu në mënyrë të gjerë te rrëfimet bindëse, emocionale,
24 të cilat edhe pse të rënda dhe që meritojnë të pranohen dhe të
25 njihen si të tilla në mënyrë të përsëritur nuk vërtetojnë

1 lidhjen e individualizuar dhe të ligjshme që qëndron me krimet
2 për të cilat ngritën akuzat.”

3 “Në këtë kontekst, Trupi Gjykues përballet me pyetjen
4 nëse vuajtja që ka ndodhur -- nuk përballet me pyetjen nëse
5 vuajtja ka ndodhur, por nëse ka prova që lidhin në mënyrë të
6 ligjshme këto vuajtje me krimet për të cilat z. Selimi
7 akuzohet në mënyrë personale.”

8 Pra, se Mbrojtja e Selimit duket se propozon dy gjëra: së
9 pari, se ne nuk kemi vërtetuar apo treguar lidhjen midis dëmit
10 të pësuar nga viktimat dhe krimet për të cilat janë ngritur
11 akuzat, dhe do ta trajtoj këtë në një çast duke u përgjigjur
12 komenteve të Mbrojtjes lidhur me provat apo dëshmitë e
13 ekspertëve; së dyti, ne pra, pretendimi është se ne nuk kemi
14 vërtetuar lidhjen midis krimeve dhe z. Selimi.

15 Përgjigja jonë për këtë pikë të dytë përmban dy aspekte
16 njëra është se nuk ka kriter apo kusht ligjor për neve që të
17 vërtetojmë ekzistencën apo lidhjen midis krimeve dhe z. Selimi
18 apo të akuzuarve të tjerë, jo në këtë fazë dhe, në fakt, as në
19 ndonjë fazë tjetër të këtij procesi. Së dyti, si pasojë, ne
20 sigurisht që nuk jemi përpjekur të bëjmë asnjë gjë të tillë.
21 Konkretisht, pra, që të vërtetojmë një lidhje midis krimeve
22 dhe z. Selimi.

23 Ajo që ne kemi bërë është që kemi paraqitur informacione
24 dhe prova lidhur me dëmin që kanë pësuar viktimat dhe kjo
25 kërkohet nga ne. Nuk është puna jonë që të vërtetojmë akuzat

1 kundër z. Selimi. Kjo është punë e Prokurorisë dhe nuk jemi
2 përpjekur të bëjmë një gjë të tillë me provat që janë marrë
3 nga ekspertët.

4 Qëndrimi ynë është që dhe ne parashtrijmë: në rast se
5 ndonjëri prej të akuzuarve shpallet fajtor dhe pastaj për të
6 vërtetuar përgjegjësinë e tyre sa i takon zhdëmtimeve, ajo që
7 duhet të vërtetohet është lidhja midis dëmit dhe krimeve për
8 të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor. Në veçanti, nuk
9 është ligji se lidhja midis sjelljes të individit dhe dëmit
10 duhet të vërtetohet. Ky ishte argumenti që u paraqit nga
11 Mbrojtja e Shalës në Çështjen 04 përpara Trupit Gjykses dhe
12 përpara Panelit të Gjykatës së Apelit i cili e rrëzoi atë më
13 29 janar të këtij viti dhe kjo është në parashtrimin e
14 protokolluar në Çështjen e Apelit 03. F73.

15 Mbrojtja e Shalës, ashtu si dhe Mbrojtja e Selimit,
16 argumentojnë se ishte e domosdoshme të tregohej, të vërtetohej
17 lidhja midis veprimeve të të akuzuarit dhe dëmit të pësuar nga
18 viktimat. Ne mund të themi me besim se ligji nuk parasheh një
19 gjë të tillë dhe citimi në ekran që shfaqet tani në
20 diapozitivin 2 e tregon atë. Paneli i Apelit vuri në dukje se
21 shkakësia apo standardet e shkakësisë, së lidhjes së
22 shkakësisë të përshkruar më lart, duke filluar me nenin 22(1)
23 të Ligjit dhe rregullin 2 të Rregullores, dhe pavarësisht nëse
24 shkakësia faktuale apo ligjore ka të bëjë, përfshihet
25 shkakësia faktuale apo ligjore -- më falni, jemi akoma në

1 diapozitivin 2. Pra, nëse shkakësia, lidhja e shkakësisë
2 ligjore dhe faktuale në fjalë kërkon, për këtë duhet lidhja
3 midis tyre dhe këto janë fjalë kyçe, pra, lidhja midis krimit
4 dhe dëmit të pësuar dhe jo sjellja e të akuzuarit dhe jo
5 lidhja midis sjelljes së të akuzuarit dhe dëmit. Paneli i
6 Apelit vlerëson se kuptimi i zakonshëm, mënyra si kuptohet në
7 mënyrë të zakonshme neni 22 i Ligjit dhe rregulla 2 e
8 Rregullores është e qartë lidhur me këtë. Për rrjedhojë,
9 zhdëmtimet që duhet të miratohen duhet të mbështeten në dëmin
10 e pësuar si pasojë e drejtpërdrejtë e kryerjes së krimit
11 brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara në lidhje me
12 cilindo person është shpallur fajtor. Paneli i Apelit
13 gjithashtu vëren se ky interpretim është në përputhje me
14 jurisprudencën e mirëpranuar tanimë të Gjykatës Penale
15 Ndërkombëtare.

16 Me fjalë të tjera, lidhja nuk është midis të akuzuarit
17 dhe dëmit të pësuar, por midis krimit për të cilin ai është
18 shpallur fajtor dhe dëmit të pësuar. Ajo që është më e
19 rëndësishme në një ndërmarrje kriminale të përbashkët, në një
20 çështje të tillë mund të përfshihet, pra, në krimet
21 individuale në të cilat i akuzuari nuk ka qenë kryesi i
22 drejtpërdrejtë. Dhe për këtë shihni paragrafin 160 të urdhrin
23 të apelit për zhdëmtim në çështjen Shala.

24 Pika tjetër e radhës këtë mëngjes - dhe këtu kalojmë në
25 diapozitivin 3 - ju lutem, është çështja e provave të marra në

1 Çështjen 06, provat e marra, kalojmë në krye të faqes dhe
2 lexojmë:

3 "Aktekspertiza apo dëshmitë e ekspertë të paraqitura nga
4 Mbrojtja e Viktimave nuk vërtetuan lidhjen e shkakësisë midis
5 krimeve për të cilat janë ngritur akuza dhe dëmit të
6 pretenduar. Jo sepse ekspertët ishin të pandershëm. Jo sepse
7 Mbrojtja kërkoi të mohojë traumën. Por sepse ekspertët vetë
8 ata në mënyrë të përsëritur dhe shprehimisht hoqën dorë nga
9 përgjegjësia apo aftësia për të përcaktuar, deklaruar se nuk
10 janë në gjendje të përcaktojnë lidhjen e shkakësisë,
11 atribuimin, diagnozën apo lidhjen konkrete me kryerësin."

12 Ky parashtrim në fakt përsërit parashtrimet e mëhershme
13 të bëra nga Mbrojtja me shkrim në këtë çështje. Dhe për këtë
14 shihni F3251, F3356.

15 Aktekspertiza në Çështjen 06 nuk kishte për synim në
16 asnjë moment që të jepte vlerësime individuale të dëmit të
17 shkaktuar ndaj viktimave. Qëllimet e kësaj aktekspertize ishin
18 të tjera dhe të shumta, përfshirë shpjegimi i kushteve të
19 rëndësishme -- i sëmundjeve apo pasojave të rëndësishme, siç
20 janë stresi post-traumatik dhe përcaktimi i dëmit që kanë
21 pësuar viktimat në kontekstin e ekspertizës dhe kërkimit
22 përkatës, hulumtimit përkatës. Duke bërë këtë, kjo ndihmon në
23 mënyrë të sigurtë Trupin Gjykses për të përcaktuar nëse
24 ekziston një lidhje midis krimeve dhe dëmit. Ne e kemi bërë të
25 qartë, më shumë se në një rast, se vlerësimet individuale nuk

1 synojnë në asnjë moment dhe nuk ishin të domosdoshme apo të
2 nevojshme, dhe Trupi Gjykses ka vendosur, pra, ka konstatuar
3 se mungesa e tyre nuk i bën këto prova as jo relevante dhe as
4 të papranueshme.

5 Në diapozitivin 3, ne kemi një fragment nga parashtrimet
6 tona lidhur me aktekspertizat ku thuhet se raporti iMMO-s i
7 përgatitur në Çështjen 06 jep kontekst dhe i paraqet një
8 shpjegim më të plotë të dëmit që kanë pësuar të gjitha
9 viktimat në këtë çështje dhe shpjegon përvojat, përjetimin e
10 dëmit nga viktimat. Ky përshkrim bëhet nga një psikiatër
11 profesionist dhe nga perspektiva psikologjike.

12 Dhe pastaj në anën e djathtë të ekranit kemi vendimin e
13 Trupit Gjykses lidhur me pranimin e dëshmive eksperte nga
14 F03451, paragrafi 26 dhe citoj:

15 "Ndonëse ekspertët u pajtuan se për të lidhur në mënyrë
16 konkrete simptomat me krimet e pretenduara do të duhej që të
17 bëhej ekzaminimi i personit në fjalë, kjo nuk është dëshmi që
18 u ofrua, u propozua në këtë çështje. Mungesa e ekzaminimeve
19 individuale të viktimave nuk i bën provat apo dëshmitë jo
20 relevante apo ekspertizën të pambështetshme. Mungesa e këtyre
21 vlerësimeve thjesht kufizon fushëveprimin apo rëndësinë e
22 relevancës së provave të propozuara dhe përfundimeve që mund
23 të nxirren nga ajo, nëse pranohet kjo ekspertizë."

24 Dhe mesa duket, Mbrojtja përsërit se raporti nuk arrin
25 qëllimin për të cilin ishte synuar, që synohej fillimisht.

1 Dhe, natyrisht, ata kanë të drejtë ta bëjnë një gjë të tillë,
2 por, për mendimin tonë, nuk është argument që qëndron.

3 Dhe, në fund, lidhur me parashtrimet e Selimit,
4 Dëshmitari W04444. Mbrojtja e Selimit mori kohë për të thënë,
5 për t'ju thënë juve, të nderuar Gjykatës, se ne në deklaratën
6 e pasojave e kishim keqinterpretuar qasjen e tyre për këtë
7 viktimë, lidhur me këtë viktimë në poshtëshënimin 306 të
8 deklaratës mbi pasojat, dhe kjo është në transkriptin 28908.

9 Ky poshtëshënim bën një parashtrim të saktë, pohim të
10 qartë se marrja në pyetje, kundërpjetet e Mbrojtjes së
11 Selimit ndaj këtij dëshmitari keqinterpretuan intervistën e
12 tij apo përsëritën, cituan deklaratën e këtij dëshmitari që ka
13 dhënë ZPS-së dhe të jap një shpjegim të shkurtër lidhur me
14 këtë.

15 Dëshmitari W04444 është rrahur derisa ka humbur
16 vetëdijen. Në intervistën e tij dhënë ZPS-së atij iu bë një
17 pyetje e qartë:

18 "A ju dhimbte trupi?"

19 Dhe kjo ishte pas rrahjes dhe ai u përgjigj:

20 "Po."

21 Dhe pastaj në faqen 24, rreshtat 6, 7.

22 Me gjithë përgjigjen që u dha, pavarësisht përgjigjes,
23 Mbrojtja e Selimit i bëri këtë pyetje dëshmitarit:

24 "Ju i thatë ZPS-së në 2019-n se ju nuk kishit dhimbje të
25 tillë gjatë atyre ditëve", pra, bëhet fjalë për "katër ditët"

1 e ndalimit të tij.

2 Dhe ky është transkripti i 9 nëntorit 2023 në 9809.

3 Kjo nuk është pyetje e drejtë. I referohet një shkëmbimi
4 të një interviste të mëparshme të cilën vetë dëshmitari në
5 mënyrë të qartë nuk i referohej rrahjes që kishte pësuar. Ata
6 i bëjnë pyetje dëshmitarit, vunë dëshmitarin në një situatë të
7 pafavorshme dhe ne e theksuam këtë në parashtrimin 306. Por
8 Mbrojtja e Selimit në vend që të kërkonte ndjesë, sugjeroi se
9 ne ishim gabim që nënvijëzuar apo theksuam këtë gabim.
10 Gjithashtu, do të thonim që është e pamundur që të shihet
11 qëllimi i kësaj pyetjeje përveç atij që ishte për të minuar
12 apo vënë në pikëpyetje Dëshmitarin W04444 dhe dhimbjen që ai
13 kishte pësuar.

14 Pra, në parashtrimin tonë, poshtëshënimi qëndron.

15 Dhe, në fund, disa fjalë duke iu përgjigjur parashtrimeve
16 të z. Krasniqi të hënën. Do t'i referohem asaj që u tha në
17 transkriptin 29045.

18 Mbrojtësi parashtroi se bëhej fjalë për një "fenomen
19 shoqëror që ekzistonte për një kohë të gjatë", pra, stigma
20 kundër bashkëpunëtorëve në Kosovë, ishte një diçka që
21 ekzistonte për një kohë të gjatë dhe kjo ishte pjesë e një
22 pranie që ekzistonte edhe më parë, pra, ishte diçka që
23 ekzistonte më parë dhe rrjedhimisht ishte e gabuar që
24 sugjeroje apo të lije të mendoje se UÇK-ja ishte përgjegjëse
25 për viktimat që kanë pësuar apo kanë vuajtur nga kjo stigmë.

1 Ne nuk pajtohemi me këtë fakt.

2 Fakti se ka ekzistuar një stigmë historike që lidhej me
3 sa u takon bashkëpunëtorëve të pretenduar nuk është në mënyrë
4 të logjikshme nuk është pengesë që viktimat kanë vuajtur nga
5 stigma apo që janë akuzuar nga UÇK-ja si bashkëpunëtorë. Në
6 fakt, në të kundërt kushtet sociale apo rrethanat sociale të
7 kësaj natyre, rrethanat shoqërore japin një kontekst të
8 përkryer të mënyrës se si UÇK-ja e ka përdorur këtë etiketim.

9 Ne e kemi trajtuar këtë në mënyrë të shpeshtë në pjesën
10 ku jemi marrë me këtë etiketim apo këtë "stigmë si rezultat i
11 krimeve të UÇK-së" në deklaratën tonë për ndikimin, për
12 pasojat dhe nuk do t'i përsërisë këto, por do të doja të
13 përfundoj duke thënë se kjo nuk ka qenë "fenomen shoqëror që
14 ekzistonte për një kohë të gjatë", pra, rrëmbimi i njerëzve
15 duke u vënë armën në kokë dhe duke e çuar ata në qendra
16 ndalimi të UÇK-së.

17 Për të marrë thjesht vetëm një shembull. Nuk ka qenë, nuk
18 ka ekzistuar një "fenomen" i tillë në jetën e W04870, pra,
19 dëshmitarit. Ajo është denigruar në mënyrë publike. Njerëzit i
20 kanë pështyrë në fytyrë në rrugë. Ajo përfundimisht nuk kishte
21 asnjë mënyrë tjetër përfundimisht, përveçse të largohet nga
22 Kosova. Dhe ky nuk ishte rezultat i një sjelljeje shoqërore që
23 ekzistonte më parë, po ishte për shkak se një anëtar i
24 familjes së saj ishte vrarë nga UÇK-ja gjatë luftës dhe ishte
25 akuzuar si bashkëpunëtor dhe sepse ajo kishte patur guximin që

1 të kundërshtonte dhe të fliste kundër kësaj.

2 Kaq kisha. Faleminderit. Këto ishin parashtrimet e mia.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Tani i kthehem Mbrojtjes së Thaçit. Ju keni kërkuar 45
5 minuta.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Përpara se të filloj
7 më jepni pak kohë që t'i transmetoj palëve disa kopje
8 *PowerPoint*, CMU-së, Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Viktimave si
9 dhe juve?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
11 faleminderit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, anëtarë të
13 Trupit Gjykses, të mërkurën e kaluar dëgjuat Mbrojtjen e
14 Thaçit që bëri disa parashtrime që kanë të bëjnë me aspektet
15 themelore të çdo gjykimi për krime lufte ku përfshihen
16 ushtarë, udhëheqës ligjorë, ku përfshihen udhëheqës politikë
17 dhe ushtarakë.

18 Ne ju thamë që nuk ka asnjë raport nga kryesit e krimeve
19 për Hashim Thaçin.

20 Ne ju thamë juve se nuk ka prova të besueshme se Hashim
21 Thaçi kishte një rol në përgatitjen dhe shpërndarjen e
22 komunikatave apo deklaratave politike.

23 Ju thamë juve se ZPS-ja nuk ju jep asnjë shpjegim
24 racional apo logjik për mënyrën se pse anëtarët e NKP-së
25 pretendohen të kenë transmetuar qëllimin e përbashkët kriminal

1 përmes komunikatave nëse UÇK-ja po të kishte patur UÇK-ja një
2 zinxhir komandues funksional.

3 Dhe ne ju thamë juve se konsensusi i provave të
4 dëshmitarëve ndërkombëtarë dhe brenda UÇK-së ishte se Hashim
5 Thaçi nuk dyshohej se ishte përfshirë në krime lufte dhe se ai
6 nuk dyshohej se ishte përfshirë në ndonjë politikë të
7 pretenduar që shënjestronte të ashtuquajturit kundërshtarë.

8 ZPS-ja të hënën nuk kishte kundërpërgjigje apo argumente
9 për të hedhur poshtë këto pika themelore. Ata nuk kishin
10 përgjigje. Nuk është që nuk kishin kohë të hënën dhe nuk mund
11 t'i trajtonin të gjitha pikat e rëndësishme. Ata kishin akoma
12 45 minuta në dispozicion kur përfunduan marrjen, ju kishin
13 ngelur dhe 45 minuta kur përfunduan kundërgargumentet e tyre.
14 Por nuk e bënë këtë gjë. Nuk kishin përgjigje.

15 Dhe duke qenë se pas kësaj, kur ata nuk ishin në gjendje
16 dhe nuk kishin mundësi që të paraqisnin kundërgargumente për
17 këto argumente thelbësore të Mbrojtjes, ZPS-ja arriti në
18 përfundimin se kundërpërgjigjet e tyre apo kundërgargumentet e
19 tyre të hënën duke pretenduar se Mbrojtja nuk do që ju të bëni
20 punën tuaj, ju Gjykatës, që të jeni Gjykatës, në të kundërt
21 Mbrojtja e di që ju do të bëni punën tuaj dhe ju do të pranoni
22 konsensusin, pra, pranimin se provat që jua kemi përshkuar
23 juve. Në fakt është Prokuroria ajo që nuk dëshiron që ju të
24 bëni punën tuaj. Ata duan që ju të bëni punën e atyre. Ata
25 duan që ju, ata dëshirojnë që ju të gjeni prova që ata nuk

1 arritën të gjenin. Por siç e thashë të hënën, Paneli në
2 gjykimin Mustafa ishte i qartë, barra e provës bie mbi ZPS-në
3 dhe vetëm mbi ZPS-në. Dhe ata dështuan në këtë.

4 Mentori im më mësoi mua para shumë kohësh se mëkati më i
5 madh në një gjykim është që të premtohet më tepër sesa mund të
6 paraqitet. Dhe ZPS-ja ka bërë këtë mëkat të madh të pafalshëm
7 në këtë gjykim. Ata kanë premtuar fishekzjarrë, spektakël, por
8 kanë paraqitur asgjë. Dhe kjo ka ndodhur edhe të hënën. Ju e
9 dëgjuat atë refrenin e tyre: "Ata thanë që do ta bënë këtë
10 gjë por nuk e bënë". Dukej se ZPS-ja në fund do të jepte një
11 shpjegim të asaj që Hashim Thaçi ka thënë apo ka bërë. Por a
12 ua dhanë ata këtë argument? Çfarë saktësisht, sipas ZPS-së,
13 tha Hashim Thaçi se do të bënte? Çfarë saktësisht, sipas ZPS-
14 së, bëri Hashim Thaçi për të zbatuar apo vënë në jetë atë që
15 ai tha? ZPS-ja nuk kishte përgjigje. Këto ishin premtimet
16 boshe të tepërta, të cilat nuk do të ndiqeshin me fakte.

17 Të kthehem tani tek një pikë e paraqitur gjatë takimeve
18 ku qëllimi i përbashkët pretendohet se u diskutua. Në
19 deklaratën tonë përmyllëse javën e kaluar, ne trajtuam
20 argumentet e ZPS-së të paraqitura në dosjen e tyre në faqen
21 870. Ju jeni në dijeni se sa e vështirë për argumentet e
22 fuqishme dhe të përsëritura të Mbrojtjes gjatë gjykimit se
23 ZPS-ja duhej të paraqiste provat e tyre para dëshmitarëve, dhe
24 ju jeni në dijeni se përgjigja e Mbrojtjes ka qenë vazhdimisht
25 që "ne nuk jemi të detyruar të paraqesim provat tona deri në

1 paraqitjen e dosjes përfundimtare". Pra, momenti i parë ku ne
2 patëm mundësi të shohim provat e tyre dhe pretendimet e tyre
3 ishte dosja përfundimtare dhe e trajtuam atë në parashtrimet
4 në deklaratat përmyllëse.

5 Një problem tjetër tejet i madh është mënyra e paraqitjes
6 së provave dhe argumentimi ligjor i ZPS-së në këtë çështje
7 duket që e bëjnë duke fshehur provat e tyre deri në dosjen
8 përfundimtare sepse duke e ditur se pala e kundërt do t'i
9 sulmojë dhe do t'i hedhë poshtë ato prova. Dhe ZPS-ja e kuptoi
10 pastaj për boshllëqet e tyre vetëm në javën e fundit kur u
11 bënë parashtrimet e Mbrojtjes. Dhe, siç parashikoi dhe priti,
12 ZPS-ja në kundërpërgjigjet e tyre, kundërargumentet e tyre
13 tani po ndryshon paraqitjen e provave duke u përpjekur për të
14 përmbushë këto boshllëqe.

15 Tani diapozitivi tjetër.

16 Për shembull, ZPS-ja pretendon në dosjen e tyre se
17 çështja e kundërshtarëve dhe lufta speciale u diskutuan në
18 mënyrë të përsëritur në mbledhjet Shtabit të Përgjithshëm. Kjo
19 është në paragrafin 75 të dosjes së tyre. Dhe kjo shihet në
20 diapozitiv. Ne i kemi analizuar poshtëshënime të mërkurën e
21 kaluar lidhur me dy takimet të 16 gushtit dhe të 29 dhjetorit.

22 Diapozitivi 4.

23 Tani, në kundërargumentet e tyre, ZPS-ja pretendon se ka
24 patur shumë të tjera në poshtëshënime. Juve ju thuhet tani se
25 kundërshtarët dhe lufta speciale janë diskutuar në takimet e

1 23 korrikut, 12, 13 nëntorit, 20 dhjetorit dhe 30 dhjetorit
2 1998. Por këto takime nuk u cituan për të mbështetur
3 paragrafin 75 të dosjes së tyre përfundimtare. Ne e kemi
4 verifikuar këtë gjë. Nuk mund të pritët nga z. Thaçi që të
5 trajtojë apo të kundërshtojë provat të cilat nuk janë
6 mbështetur nga ZPS-ja në mbështetje të pretendimeve të tyre në
7 paragrafin 75.

8 Fakti që ZPS-ja nuk ka cituar, nuk ka përmendur asnjë
9 prej këtyre takimeve dhe që këto i përmendën vetëm në
10 kundërpërgjigjet e tyre, në vetvete është një pranim, një
11 formë për të pranuar se ZPS-ja besonte se këto takime në fakt
12 nuk i ndihmojnë ata në vërtetimin e çështjes së tyre.

13 Diapozitivi 5.

14 Duhet të konstatojmë lidhur me përmendjen e re të
15 takimeve të dhjetorit se ZPS-ja nuk pretendonte se z. Thaçi
16 ishte aty apo se ata ishin.

17 Diapozitivi 8.

18 Së fundi, ne vërejmë se në secilin prej këtyre takimeve
19 shtesë se Bislum Zyrapi të paktën ka qenë i pranishëm në qoftë
20 se nuk ka qenë drejtues i këtyre takimeve.

21 Kalojmë tek diapozitivi 9.

22 Javën e shkuar ne theksuam pozicionin e ZPS-së që është
23 ndërmarrë në paragrafët 1431 dhe 1432 të dosjes së tyre
24 përfundimtare, ku Zyrapi, citoj "nuk ishte pjesë e Shtabit të
25 Përgjithshëm dhe rrethit të brendshëm të cilët i përkisnin të

1 akuzuarit" dhe "nuk besohej plotësisht nga të gjithë anëtarët
2 e UÇK-së, përfshirë këtu edhe anëtarë të caktuar të Shtabit të
3 Përgjithshëm" dhe, për rrjedhojë, "faktorë të tillë do të
4 ndikonin deri në masën që anëtarët e NKP-së do të diskutonin
5 haptazi politikatat kundër oponentëve me të".

6 Diapozitivi 10.

7 Ne gjithashtu kemi vënë në dukje që ZPS-ja në
8 parashtrimet përfundimtare të veta parashtroi se Zyrapi ishte
9 "njëri prej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm që nuk ishte
10 pjesë e grupit të personave të besuar. Ai ishte person i
11 jashtëm". Këtë ZPS-ja e thotë në transkript në faqen 28468.

12 Të mërkurën, i kërkuam ZPS-së të na shpjegonte se si
13 arriti në këtë përfundim, sepse si ishte e mundur që këto
14 diskutime ishte diskutuar avancimi i qëllimit të përbashkët
15 kriminal, ndërkohë që Zyrapi ka qenë i pranishëm në to dhe
16 Zyrapi të mos ishte anëtar i NKP-së. Ne nuk dëgjuam asnjë
17 përgjigje nga Prokuroria të hënën. Dhe arsyeja për këtë është
18 që Prokuroria nuk ka përgjigje. Kjo është një situatë që nuk
19 ka kuptim.

20 Kalojmë tek diapozitivi 11.

21 Në vend që të na jepte shpjegime ZPS-ja të hënën u përpoq
22 që të ndryshonte pak qasjen e vet ndaj Zyrapit, tani të
23 informuar sesa e kanë dëmtuar argumentet e veta duke pranuar
24 që Zyrapi nuk ishte pjesë e NKP-së?

25 Juve e dëgjuat, të nderuar Gjykatës, që ishte Mbrojtja që

1 po jepte informacion çorientues, domethënë, kinse Mbrojtja po
2 pretendonte që "persona që nuk ishin anëtarë të caktuar me
3 emër të NKP-së kanë qenë persona të cilët duhet të kishin
4 marrë informacion sa i takon zbatimit të qëllimi të
5 përbashkët".

6 Diapozitivi 12.

7 Megjithatë, më lejoni t'i shpjegoj pak më tepër këto
8 argumente. Së pari, nuk është Mbrojtja që e ka vendosur
9 Zyrapin jashtë NKP-së, Prokuroria e ka bërë këtë gjë. Ne
10 vërejtëm që Paneli i Apelit në këtë çështje penale tha dhe u
11 shpreh që janë identifikuar anëtarët e NKP-së dhe gjithashtu
12 vendosi, dhe këtu citoj, që "ZPS-ja duhet t'i japë Mbrojtjes
13 të gjithë informacionin që ka në dispozicion sa i takon
14 anëtarëve të pretenduar të NKP-së" dhe vijon më tej vendimi,
15 "në qoftë se ZPS-ja do jetë në pozicion që të identifikojë
16 anëtarë të tjerë shtesë të NKP-së me emër, këtë informacion
17 duhet t'ia japë Mbrojtjes".

18 Në qoftë se në këtë pikë kohe Prokuroria nuk ka prova të
19 mjaftueshme për të thënë që Zyrapin është anëtar i NKP-së, mund
20 të mbërrihet në përfundimin që ZPS-ja nuk pretendon që ai të
21 jetë anëtar i NKP-së, ose në të kundërtën i takon që ZPS-ja ka
22 shkelur vendimin e Panelit të Apelit.

23 Së dyti, Mbrojtja nuk e ka thënë këtë gjë, por ZPS-ja e
24 ka thënë në fakt që Zyrapin ishte "i vetmi anëtar i Shtabit të
25 Përgjithshëm që nuk ishte pjesë e grupit të personave të

1 besuar. Ai ishte person i jashtëm". Këtë e ka thënë ZPS-ja jo
2 ne. ZPS-ja jo Mbrojtja, po ashtu ju ka paraqitur një
3 organigramë të funksionimit të Shtabit të Përgjithshëm dhe ju
4 tha shprehimisht që Zyrapi nuk pretendohet të jetë anëtar i
5 NKP-së. Sërish ishte ZPS-ja që ju tha ju, dhe këtu citoj, që
6 ai "nuk besohej plotësisht nga anëtarët e Shtabit të
7 Përgjithshëm", dhe se citoj sërish, "faktorë të tillë do
8 ndikonin deri në masën që anëtarë të NKP-së nuk diskutonin
9 haptazi në praninë e tij politika kundër oponentëve". E vetmja
10 mënyrë për të interpretuar qëndrimin e ZPS-së ndaj Zyrapit
11 është që Prokuroria nuk e konsideron atë anëtar të NPK-së.
12 Fakti që Prokuroria nuk ndihet rehat me këto parashtrime të
13 veta pasi dëgjoi parashtrimet e Mbrojtjes nuk e përmirëson
14 situatën e vet. Kështu që për këtë arsye, ne parashtrojmë që
15 ZPS-ja duhet që të na kishte dhënë shpjegimet e nevojshme dhe
16 nuk e dimë sesi ZPS-së i del llogaria që nga njëra anë thotë
17 që Zyrapi ka qenë person i jashtëm, ndërkohë që nga ana tjetër
18 thotë që Zyrapi ka qenë i pranishëm në të gjitha takimet dhe
19 nuk e di se si Prokuroria e zhvesh Zyrapin nga qëllimi i
20 përbashkët kriminal, në qoftë se ky do ekzistonte.

21 Pretendimi i ZPS-së që Zyrapi ka dhënë dëshmi duke thënë
22 që ai "ishte i informuar për politikën ndaj oponentëve". Kjo
23 jepet në transkript në faqen 29106. Është një qëndrim jo i
24 saktë. Sepse Bislam Zyrapi në asnjë moment kohe, as nuk ka
25 deklaruar dhe as nuk sugjeruar që ka qenë i informuar për një

1 politikë në Shtabin e Përgjithshëm për të etiketuar të
2 ashtuquajturit oponentë, për t'i ndaluar ata, keqtrajtuar apo
3 për t'i vrarë. Në fakt, pjesa që citoi ZPS-ja në mbështetje të
4 pozicionit të vet, qëndrimit të vet ishte e paqartë.

5 Kalojmë tek diapozitivi 13.

6 Zyrapit vazhdoi dhe tha në gjykimin kundër Milutinovic se:

7 "... kam dëgjuar nga komandantët e zonave dhe civilët që
8 disa ushtarë dhe zyrtarë i kanë tejkaluar kompetencat e tyre.

9 "Në atë kohë nuk bëja dot asgjë sepse nuk kisha asnjë
10 funksion. Pasi u bëra Shef i Shtabit, unë e përmenda të hënën
11 se çfarë masash kemi marrë për të disiplinuar ushtrinë."

12 Dhe për referencë mund t'i referoheni provës 1356.

13 Anëtarë të Trupit Gjykses, ju e dini që këto janë masat
14 që janë dhënë në provën 1D28. Ky është konteksti i asaj çfarë
15 ka thënë. Ai asnjëherë nuk ka pretenduar që ka pasur njohuri
16 që ka pasur politika të tilla nga Shtabi i Përgjithshëm. Për
17 shembull, ai asnjëherë nuk ka thënë që është përballur me
18 rezistencë brenda Shtabit të Përgjithshëm për të realizuar
19 urdhrin që është i dhënë në provën 1D29.

20 Kalojmë tek diapozitivi tjetër i cili nuk duhet të
21 transmetohet për publikun.

22 Sikurse ju thashë edhe përpara një jave, Zyrapit e ka
23 thënë në 2005-n se përpara fundit të nëntorit të 1998-s,
24 Shtabi i Përgjithshëm nuk kishte nxjerrë asnjë urdher për
25 ndalimet dhe ndalimet ishin një çështje që ishin trajtuar nga

1 komandantët e zonës. Ai ka 20 vjet që thotë të njëjtën gjë, ka
2 të njëjtin refren. Nuk është e mundur që ai të ketë thënë në
3 të njëjtën kohë që ka qenë i informuar për politikën e Shtabit
4 të Përgjithshëm për të shënjestruar bashkëpunëtorët, dhe
5 përsëri për 20 vjet të kishte thënë që çështjet e ndalimit
6 ishin çështje që trajtoheshin prej komandantëve të zonës dhe
7 jo prej Shtabit të Përgjithshëm. ZPS-ja as nuk u mundua fare
8 që t'ju shpjegonte se si mund të anashkalonin këtë dëshmi që
9 është dhënë përpara një kohe të gjatë dhe kjo është arsyeja,
10 sipas nesh, që ZPS-ja nuk e ka përgjigjen as vetë.

11 Diapozitivi 15.

12 Tani le të kalojmë tek çështja e komunikatave. Ne si
13 Mbrojtje ju thamë javën e shkuar që ZPS-ja nuk asnjë pikë
14 prove që z. Thaçi ka lidhje me autorizimin e komunikatave ose
15 deklaratave politike përveç pretendimeve të paverifikuara të
16 z. Selimi në intervistën e ZPS-së lidhur me Komunikatën 59, të
17 cilat nuk janë të besueshme për të cilat i kemi parashtruar
18 dhe më parë. Në fakt, ZPS-ja nuk ka asnjë provë tjetër që
19 tregon që z. Thaçi është i përfshirë në përgatitjen e
20 komunikatave, diskrediton më tej atë çfarë ka thënë z. Selimi
21 në intervistën për ZPS-në lidhur me Komunikatën 59. Ne ju
22 thamë javën e shkuar që ZPS-ja nuk ka madje asnjë provë
23 tjetër, por nuk është mbështetur në asnjë lloj reference të
24 dorës së dytë që është paraqitur një libër ose në ndonjë
25 *manuskript* të pabotuar ose në intervista të tjera të gazetave

1 në atë kohë.

2 Kështu që ju mund të mbërrini në përfundimin që
3 interpretimi i arsyeshëm i provave është që z. Thaçi nuk ishte
4 i përfshirë në përgatitjen dhe shpërndarjen e komunikatave dhe
5 deklaratave politike.

6 Ne kemi parashtruar, gjithashtu, që nuk ka provë të
7 lidhjes kohore ose gjeografike me asnjë komunikatë dhe krime
8 të ngritura në aktakuzë. Në fakt ishte mbresëlënëse që ZPS-ja
9 përsëri në kundërrargumentet e veta nuk mundi që të shpjegonte
10 me fjalë të thjeshta provat në të cilat ajo mbështet për
11 vërtetuar lidhjen. Çfarë lidhje ka z. Thaçi dhe komunikatat?
12 Ne ende nuk e dimë se çfarë lidhje qëndron midis këtyre të
13 dyjave. Në cilën prej deklaratave publike të z. Thaçi dhe cila
14 prej tyre ka kontribuar për krimet e ngritura në aktakuzë?
15 Edhe sot e kësaj dite në këtë moment ne nuk e dimë përgjigjen
16 e kësaj pyetjeje.

17 Në vend që të na jepte përgjigjet Prokuroria na dha disa
18 citime të numrave të provave materiale. Dhe këtë Prokuroria
19 nuk e bëri se s'kishte kohë, po ishte e qëllimshme. Në vend që
20 të lexonte dëshmitë, ZPS-ja zgjodhi që t'ju jepte një listë
21 provash materiale ku juve ju duhet të nxirrni informacionin
22 dhe pastaj ta lidhni atë me njëri-tjetrin.

23 Prokurorët kanë vetëm dëshmi tymnaja dhe ajo çfarë bënë
24 Prokurorët është që shpenzuan vetëm disa minuta duke lexuar
25 provat përpara Gjykatës. Një shembull i famshëm i kësaj

1 praktike është gjykimi i Radovan Karadzic, ku Prokuroria
2 vërtetoi synimin kriminal të Karadzic duke cituar Karadzic që
3 jepte një fjalim përpara parlamentit boshnjak që i referohej
4 pavarësisë së Bosnjës si "autostradë ferri" që do të
5 rrezikonte "zhdukjen e myslimanëve".

6 A mund të imagjinoni Prokurorin në atë çështje që të
7 ngrihet në këmbë dhe në dokumentet dhe në parashtrimet
8 përfundimtare në vend që të vërtetonte synimin kriminal të
9 Karadzic duke lexuar fjalimet e bëra përpara parlamentit serb
10 në vend të kësaj, prokuroria të kishte dhënë një listë të
11 numrave të provave? Një gjë e tillë nuk do të kishte ndodhur
12 kurrë me atë prokurori.

13 Pyetja që bëj unë është kjo: Pse e bën Prokuroria këtë
14 gjë në këtë çështje gjyqësore? Arsyeja është se ZPS-ja nuk ka
15 prova për të mbështetur argumentin e vet. Thelbi i dokumenteve
16 është kaq i dobët sa që edhe po t'i referohen këtyre
17 dokumenteve, ZPS-ja do ta bëjë edhe më të dobët argumentin e
18 vet. Në rastin më të mirë, argumentet e ZPS-së janë një arnim
19 dokumentesh që ua ka lënë ju si detyrë që t'i mblidhni me
20 njëra-tjetrën, të nderuar Gjykatës. Dhe kjo nuk përmbush
21 barrën e provës së Prokurorisë.

22 Diapozitivi 16.

23 ZPS-ja po ashtu vazhdon të pretendojë që ndërkombëtarët
24 nuk ishin të informuar lidhur me dokumentet dhe komunikatat e
25 UÇK-së, duke cituar ndërmjet të tjerëve edhe dëshminë e

1 dëshmitarit Clark. Por në qoftë se ju kujtohet dëshmia e
2 Gjeneralit Clark lidhur me tri takimet e tetorit me
3 Milosheviqin, ai na tha që në këto takime i kishte thënë
4 Milosheviqit që NATO do të bombardonte vendin e vet në qoftë
5 se Milosheviqi nuk do të ndërpriste sulmet ndaj Kosovës.
6 Sigurisht që Milosheviqi ka qenë i informuar për komunikatat.
7 Se në fund të ditës Kosova ishte një provincë e ish-
8 Jugosllavisë dhe e gjithë provinca, sikurse ju e dini, ishte
9 në mbikëqyrjen e plotë të tij. Do të kishte qenë në interesin
10 e vetë Milosheviqit që t'i tregonte Gjeneralit Clark, NATO-s,
11 Grupit të Kontaktit dhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të
12 Bashkuara këto komunikata gjoja nxitëse në qoftë se ai dhe
13 shërbimi i tij do të besonin se këto komunikata do të jepnin
14 një kontribut domethënës ndaj krimeve të luftës dhe krimeve
15 kundër njerëzimit. Fakti që Gjenerali Clark dhe Ambasadori
16 Hill nuk mbajnë mend asnjë argument të ngritur nga Milosheviqi
17 sa i takon komunikatave demonstroi që madje as autoritetet
18 serbe nuk gjejnë ndonjë lidhje mes komunikatave dhe krimeve të
19 pretenduara të Prokurorisë.

20 ZPS-ja ngriti disa argumente të dobëta të hënën, njëra
21 prej të cilave ishte që Mbrojtja pretendonte që ndërkombëtarët
22 thanë që UÇK-ja nuk kishte kryer asnjë krim. Mbrojtja nuk e ka
23 thënë asnjëherë një gjë të tillë. Mbrojtja tha që dëshmitarët
24 ndërkombëtarë nuk dyshonin që Hashim Thaçi të përfshihej në
25 kryerjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.

1 ZPS-ja nuk e kundërshton faktin që në fakt ky ishte qëndrimi i
2 ndërkombëtarëve. Ne gjithashtu thamë që ndërkombëtarët nuk i
3 shikonin komunikatat si nxitëse të krimeve. Dhe ZPS-ja as këtë
4 argument tonin nuk e rrëzoi. Është e pamundur që komuniteti
5 ndërkombëtar nuk do të kishte qenë i informuar për efektin e
6 komunikatave në qoftë se argumentet e ZPS-së ishin vërtetë
7 deduksion i arsyeshëm. Kam përmendur dhe më herët çështjet e
8 Ruandës, Bosnjës, Serbisë ku ishte informacion i ditur
9 botërisht propaganda për nxitje të krimeve të cilat kanë
10 ndodhur në vendet përkatëse. Kështu që argumenti i ZPS-së nuk
11 mund të qëndrojë dhe janë dashur 20 vite për të zbuluar
12 pretendime të tilla ose retorika të tilla nxitëse në Kosovë.

13 Kalojmë tek gjykata ushtarake. Besoj që ju kujtohet që të
14 hënën ZPS-ja në intervistën e vet tha që z. Thaçi ka krijuar
15 ose ka ndihmuar për krijimin e gjykatës ushtarake, por z.
16 Thaçi nuk ka thënë këtë gjë. Z. Thaçi ka thënë që në kohën kur
17 është nxjerrë prova 1D28 ishte krijuar gjykata ushtarake dhe
18 në fund të nëntorit ai nuk ishte më në Kosovë, pra, ishte
19 larguar prej Kosovës. Pra, është e padiskutueshme që, në fakt,
20 z. Thaçi nuk ka qenë në Kosovë gjatë asaj kohe. Pra, edhe sa i
21 takon bisedave me Fred Abrahams edhe kjo bisedë në vetvete nuk
22 ka çuar në vërtetimin e krimit të gjykatës ushtarake apo
23 lidhjes së z. Thaçi me 1D28.

24 Diapozitivi 18.

25 Sa i takon argumentit që as urdhri i 28 nëntorit dhe as

1 gjykata për drejtësi ushtarake janë sulmuar për t'i dhënë fund
2 politikave të oponentëve ose zbatimeve të saj, dhe këtu
3 citova, kjo është në fakt ë rrëzuar edhe nga Zyrapit vetë. Dhe
4 këtë informacion më në hollësi edhe në diapozitivin që keni
5 përpara është në faqen 17539, 17540.

6 Dy diapozitivat e tjerë nuk i duhen paraqitur publikut.

7 Do të kalojmë tek të ashtuquajturit dy gazetarë serbë.
8 Një tjetër argument i dobët ky i ZPS-së lidhur me dy
9 gazetarët. Sipas ZPS-së, Mbrojtja ka pretenduar që personat
10 janë ndaluar sepse njëri prej këtyre personave ka qenë i
11 dyshuar për krime lufte në Kroaci dhe në Bosnjë. Ne s'e kemi
12 thënë asnjëherë këtë gjë.

13 Sikurse i thashë Gjykatësit Barthe të hënën, fakti që
14 njëri prej tyre ka qenë i ashtuquajtur gazetar është tanimë i
15 njohur jo vetëm që ka qenë një luftëtar në luftërat e Kroacisë
16 edhe Bosnjës, po gjithashtu edhe anëtar i forcave paramilitare
17 serbe, pra, kjo në vetvete mbështet deduksionin e arsyeshëm që
18 ata po vepronin në mënyrë të dyshimtë dhe, për rrjedhojë,
19 ndalimi i tyre ushtarak ishte i arsyetueshëm. Duam që t'ju
20 referojmë gjithashtu edhe dëshminë e dëshmitarit Byrnes në
21 këtë pikë në transkript në faqet 13690, 13691.

22 Kalojmë tek diapozitivi tjetër që mund të paraqitet për
23 publikun.

24 Të hënën Prokuroria më pas u mundua që të trajtonte vetëm
25 pjesë të raportit të ICRC-së ku u mbështetën, ndërkohë që ata

1 nuk morën parasysh pjesën e dytë të raportit ku thuhet, dhe
2 citoj "mund të duhet kohë, mund të duhen dhe burime për të
3 përcaktuar dhe zbatuar procedurat efektive të analizimit".
4 Qëndrimi i ZPS-së që grupet e armatosura joshtetërore duhet të
5 kenë një sistem plotësisht funksional që në ditën e parë, jo
6 vetëm që nuk është i arsyeshëm por është në konflikt të qartë
7 me qëndrimin e ICRC-së.

8 Përsëri, si çështje politikash, ne ju inkurajojmë që të
9 mos përcaktoni dhe të mos vendosni precedentë të rrezikshëm
10 ndërkombëtarë që grupet e armatosura joshtetërore duhet që të
11 kenë një sistem të plotë të drejtësisë përpara sesa të kenë
12 mundësi që të ndalojnë të burgosurit.

13 Diapozitivi 22.

14 Kalojmë me elementin e Qirezit. Juve keni dëgjuar sa i
15 takon incidentit të Qirezit që delegacioni ka bërë avokaci për
16 çarmatim. Por megjithatë kjo nuk ka lidhje me parashtrimet
17 tona dhe lidhet me atë çfarë na pyeti Gjykatësi Barthe. Pyetja
18 që shtrohet është në qoftë se ndalimi, pra, mbështeste
19 objektivin ushtarak ose në qoftë se ishte një ndalim që ishte
20 krijuar për të fituar kontroll në të gjithë Kosovën. Në qoftë
21 se bëhej fjalë për një aspekt juridik apo jo kur u bë ndalimi
22 kjo shkon përtej diskutimit. Çështja ose argumenti i ZPS-së
23 është një deduksion jo i arsyeshëm dhe nuk ka lidhje me atë
24 çfarë pretendohet prej saj.

25 Diapozitivi 23.

1 Siç edhe mund ta shikoni, këtu pretendohet një plan i
2 përbashkët kriminal që duket sikur shpaloset me përpjekjet
3 legjitime për luftë në një situatë lufte. Atëherë Gjykatësi
4 Barthe, në qoftë se ju kujtohet, ka bërë një pyetje të hënën
5 duke e pyetur ZPS-në dhe këtu citoj: Si duhet Trupi Gjykes të
6 bëjë dallimin midis një kontributi domethënës me qëllim të
7 përbashkët për të fituar dhe për të ushtruar kontroll në të
8 gjithë Kosovën përmes kryerjes së krimeve nga sjellja që kanë
9 kontribuar për UÇK-në ose luftën e përgjithshme të UÇK-së?
10 ZPS-ja vazhdoi duke thënë që ne, pra, Mbrojtja, "nuk e kemi
11 kuptuar fushëveprimi e NKP-së që mund të shtrihet në veprime
12 të cilat pretendohen se avancojnë objektivat ushtarake ose që
13 kanë motivime personale". ZPS-ja tha që:

14 "Njerëzit mund të kenë arsye të ndryshme për të bërë
15 diçka të tillë dhe kjo është arsyeja se pse motivi në
16 përgjithësi nuk është i rëndësishëm për synimin kriminal."

17 Diapozitivi 24.

18 Gjithsesi argumentet tona janë si më poshtë.

19 Së pari, paragrafët e Tadic diskutojnë se në qoftë se ka
20 pasur një kërkesë të përgjithshme shtesë për motivin si pjesë
21 të *mens rea*.

22 Së dyti, ZPS-ja nuk mund të pretendojë se ka një shpjegim
23 alternativë të ndryshëm nga objektivi ushtarak, por
24 pretendimin e vet duhet ta mbështesë me prova. Për shembull,
25 ZPS-së i kërkohet që të provojë që të dy gazetarët janë

1 ndaluar për shkak të objektivit të pretenduar të UÇK-së për të
2 fituar dhe ushtruar kontroll në të gjithë Kosovën.

3 Së treti, në qoftë se ZPS-ja nuk e provon këtë përmes
4 provave të drejtpërdrejta, atëherë ata ju kërkojnë juve që të
5 arrini në një deduksion. Ku ngrihet një pyetje, në qoftë se
6 një arrestim ose ndalim është kryer për një qëllim ushtarak
7 ose në mbështetje të planit të përbashkët, ZPS-ja ju kërkon
8 juve që të arrini në një deduksion tuajin që, në fakt, ky
9 veprim është bërë në mbështetje të planit të përbashkët, por
10 duhet që ZPS-ja të kishte përfunduar të gjithë përfundimet e
11 veta të arsyeshme. Ndërkohë që ZPS-ja nuk ka bërë pikë
12 përpjekjeje për ta bërë të qartë pozicionin e vet përmes
13 provave.

14 ZPS-ja thotë që "njerëzit mund të kenë arsye nga më të
15 ndryshmet për të bërë diçka dhe për këtë arsye motivi
16 përgjithësisht nuk është i rëndësishëm për synimin kriminal".
17 Por ky argument e anashkalon barrën e provës së ZPS-së siç
18 parashikohet në rregullën 140(3). Në qoftë se ekzistojnë arsye
19 të ndryshme se pse janë bërë ndalimet dhe në qoftë se një prej
20 këtyre arsyeve ose deduksioneve të arsyeshëm është në
21 përputhej me pafajësinë, atëherë ZPS-ja nuk e ka shpjeguar
22 këtë bazë.

23 Së katërti, në aktgjykimin kundër Limajt është shpjeguar
24 kjo situatë shumë mirë, në të thuhet që është bërë "ndarja
25 midis objektivave ushtarake për të shënjestruar individë që

1 mendoheshin si bashkëpunëtorë të forcave serbe" krahasimisht
2 me fenomenin e "civilëve shqiptarë të Kosovës të cilët mund të
3 jenë rrëmbyer për arsye të tjera si, për shembull, hakmarrje
4 personale të anëtarëve të UÇK-së e të motive të tjera". Kjo
5 jepet në paragrafin 216 të çështjes Limaj.

6 Bëhet fjalë për të njëjtën luftë, nuk është luftë tjetër
7 kjo që ka trajtuar Prokuroria. Dhe motivi nuk është jo i
8 rëndësishëm këtu.

9 Diapozitivi 25.

10 Sa i takon Qirezit, ne e dimë që ZPS-ja as nuk e mori
11 mundimin fare që të shpjegonte se si videoja e konferencës për
12 shtyp të incidentit të Qirezit pati ndikim mbi besueshmërinë e
13 deklaratës së Dedajt të dhënë për EULEX-in në vitin 2014.
14 Përsëri, ZPS-ja nuk e mbështet pretendimin e vet me prova.

15 Diapozitivi 26.

16 Të martën ZPS-ja ju tha që Dedaj që kishte deklaruar në
17 2014-n që i kishte dhënë EULEX-it një fotografi të vetes së
18 vet të bërë dy ose tre ditë më përpara. Po në këtë çështje
19 gjyqësore kujtohet fotografi nuk është treguar fare, si
20 rezultat nuk është pjesë e dosjes gjyqësore. Mendoj që ZPS-ja
21 dëshiron që ju, të nderuar anëtarë të Trupi Gjykses, të
22 imagjinoni se çfarë pamje mund të kishte pasur kjo fotografi
23 në vend që të shikonit me sytë tuaj videon që ju paraqiti ZPS-
24 ja. Pra, ZPS-ja po ju thotë që përdorni imagjinatën, të
25 nderuar Gjykatës, mos i besoni syve tuaj kur patë këtë videon

1 që kishte të bënte me z. Dedaj.

2 Pra, kjo më çon mua në pyetjen hipotetike: Kush nuk
3 dëshiron që ju të jeni vërtetë Gjyqtarë dhe të tregoni të
4 vërtetën, ne apo ZPS-ja?

5 Së fundi, z. Thaçi nuk i ka thënë asnjëherë ZPS-së që ka
6 pasur informacion "për ndalime dhe për persona të cilët janë
7 rrahur". Për shembull, në qoftë se do të lexoni intervistën e
8 z. Thaçi besoj se do të identifikoni lehtësisht që z. Thaçi i
9 janë bërë shumë pyetje ku qëllimi kryesor i ZPS-së ishte që të
10 thoshte në qoftë se kishte parë persona "të rrahur ose të
11 keqtrajtuar", pra, bëhet fjalë për pyetjet e thëna në lloj-
12 lloj formash për të marrë përgjigjen e z. Thaçi për këtë
13 pyetje. Keqtrajtimi mund të ketë përkufizim të ndryshëm, mund
14 të përfshijë, për shembull, abuzim verbal, mund të ketë
15 kuptimin e kacafytjeve fizike, e të tjerë. Dhe nuk është e
16 qartë se si i ka kuptuar z. Thaçi pyetjet, por ajo çfarë dimë
17 ne është që z. Thaçi ka thënë që personalisht nuk ka parë
18 asnjë lëndim fizik mbi askënd, gjë e cila është në përputhje
19 me videon për incidentin e Qirezit që e kemi parë të gjithë.

20 Tani le të flasim pak për bojkotimi e LDK-së.

21 Diapozitivi 27.

22 ZPS-ja nuk citon asnjë provë që LDK-ja bojkotoi Qeverinë
23 e Përkohshme për shkak të keqtrajtimit të pretenduar prej z.
24 Thaçi ose ndokujt tjetër. Sikurse e thamë dhe javën e shkuar,
25 ZPS-ja nuk i referohet asnjë prove të asaj kohe dhe asnjë

1 qëndrimi të LDK-së. Dhe as të hënën nuk na dha asnjë
2 informacion shtesë lidhur me këtë.

3 Përkundrazi, ju keni provat e asaj kohe që LDK-ja ka
4 bojkotuar Qeverinë e Përkohshme sepse nuk dëshironte njësoj
5 vendet brenda Qeverisë së Përkohshme. Gjithashtu LDK-ja kishte
6 qeverinë e vet paralele në të njëjtën kohë që ka funksionuar
7 Qeveria e Përkohshme dhe, në fakt, ka refuzuar që të tërhiqet
8 prej qeverisë së saj paralele deri në shkurt të vitit 2000.
9 Këtë e keni dëgjuar nga dëshmitari Covey. Kjo është arsyeja
10 kryesore se pse nuk iu bashkua Qeverisë së Përkohshme LDK-ja,
11 jo abuzimi i pretenduar.

12 Z. Thaçi në të vërtetë ka qenë gjithëpërfshirës. Sikurse
13 mund ta shikoni në këtë diapozitiv në paragrafin 64 të dosjes
14 sonë përfundimtare, ne i kemi cituar të paktën 15 raste të
15 ndryshme ku z. Thaçi i ka bërë thirrje LDK-së që të bëhej
16 pjesë e qeverisë. Ndërkohë që në kundërpërgjigjet e veta ZPS-
17 ja të hënën iu referua vetëm njëerës prej këtyre thirrjeve.

18 Diapozitivi 28.

19 Atëherë sa i takon çështjes së këshillit të personelit,
20 nuk përmendet fare këshilli i personelit as në dosjen
21 përfundimtare apo as në aktakuzë.

22 Dhe në çështjen në jurisprudencën e ICL-së thuhet që "në
23 qoftë se Prokuroria parashikon të akuzuarin, pra, është e
24 rëndësishme që Prokuroria të japë informacion të qartë në kohë
25 dhe konsistent".

1 Ndërkohë që Prokuroria nuk ka bërë asnjë nga këto gjëra.

2 Në qoftë se do ta kishte ngritur si çështje Prokuroria
3 elementin e këshillit të personelit, ne do t'i kishim bërë
4 pyetje Zyrarit lidhur me këtë, dhe ne parashtrojmë që jemi
5 paragjykuar për shkak të faktit që nuk na është përmendur
6 asnjëherë më përpara një element i tillë.

7 Diapozitivi 29.

8 Po ashtu, Prokuroria i është referuar një prove që janë
9 shënime të panëshkruara me ish-anëtarë të UÇK-së ku
10 diskutohet për historikun e UÇK-së. Në qoftë se do lexojmë
11 këto faqe, do lexoni ka konfuzion dhe mospajtim midis
12 anëtarëve në këtë takim lidhur me mënyrën se kur themeluar
13 UÇK-ja dhe cilët kanë qenë themeluesit e saj.

14 Le të kalojmë tek pika në qoftë se ka provë për takimet e
15 Qeverisë së Përkohshme në verë të vitit 1999. ZPS-ja nuk mori
16 parasysh parashtrimet tona duke lënë mënjanë faktin që ZPS-ja
17 iu referua procesverbalit të Shtabit të Përgjithshëm lidhur me
18 pretendimet e Mbrojtjes sa i takon takimeve të Qeverisë së
19 Përkohshme.

20 Pra, të gjitha provat që citon Prokuroria janë të
21 paverifikuara, janë dokumente të cilat janë paraqitur për
22 praninë në prova materiale si prova jогоjore dhe nuk ka dhënë
23 asnjë dëshmitar asnjë dëshmi për të vërtetuar autenticitetin
24 dhe për të konfirmuar pjesët përkatëse.

25 Më tej ZPS-ja thotë që Mbrojtja e Thaçit ka bërë një

1 keqinterpretim lidhur me këtë pikë, por ndërkohë ne nuk kemi
2 bërë asnjë keqinterpretim.

3 Diapozitivi 31.

4 Edhe një herë ne do t'ju tregojmë në dosjen përfundimtare
5 të Prokurorisë në pasqyrën e lëndës, ku ata kanë një seksion
6 të tërë që pretendojnë që t'i japin përgjigje pyetjeve të
7 cilat kanë të bëjnë me pretendimin për planin kriminal të
8 përbashkët. Por në këtë seksion ju mund të shikoni që nuk ka
9 asnjë provë që vërteton që plani i përbashkët kriminal është
10 shpërndarë përmes urdhrave me shkrim.

11 Edhe një herë z. Thaçi mund të trajtojë argumente kundër
12 tij vetëm në qoftë se argumentet e Prokurorisë janë të qarta.

13 Diapozitivi 32.

14 Gjithashtu, në kundërpërgjigje ZPS-ja thotë që në provën
15 P1581, një dëshmitar në Gjykatën e Kosovës ka vërtetuar për
16 marrjen e një urdhri të drejtpërdrejtë. Ky dëshmitar ka thënë
17 në fakt se nuk e dinte në qoftë se ky urdhër vërtetë ishte
18 nxjerrë prej Shtabit të Përgjithshëm apo jo. Por thotë që
19 mbështetet në fjalën e një personi që ka vdekur. Domethënë,
20 nuk kemi të bëjmë me prova të drejtpërdrejtë por me
21 thashetheme të dëgjua këtu-aty.

22 Mbështetja e ZPS-së në këtë dëshmi është emblematike dhe
23 është shumë domethënëse dhe ky është një qëndrim që ZPS-ja e
24 tregon edhe në vende të tjera në dosjen e vet.

25 ZPS-ja gjithashtu thotë që provat shfajësuese nuk janë

1 kundërshtuar sepse ishin shfajësuese. Por duam t'ju tërheqim
2 vëmendjen e Dëshmitarit W04760 dhe paaftësinë e ZPS-së për të
3 dhënë ndonjë shpjegim të kuptimtë për tërheqjen e dëshmitarit
4 të tyre përveçse faktit që e kuptuan që dëshmia e dëshmitarit
5 ishte shumë shfajësuese dhe nuk i shërbente qëndrimit të tyre.

6 Diapozitivi 33.

7 Tani le të kalojmë tek Sokol Bashota. ZPS-ja pretendon se
8 prova e Bashotës është "e pamundur të lexohet" si hipotetike.
9 Por ju thashë që për një javë që asnjë hetues i TPNJ-së nuk do
10 të kishte rënë në qëndrimin që të mos bënte pyetje të tjera
11 plotësuese në qoftë se ata do besonin që z. Bshota nuk po
12 fliste hipotetikusht.

13 Unë do them që i njëjti qëndrim zbatohet dhe për ZPS-në.
14 Në seancën përgatitore të tij, ZPS-ja asnjëherë nuk i ka bërë
15 pyetje plotësuese Bashotës për të vërtetuar se kur, ku apo
16 kush në Shtabin e Përgjithshëm ka marrë pjesë në diskutimet
17 lidhur me ekzekutimin e bashkëpunëtorëve.

18 Kalojmë tek diapozitivi 34.

19 ZPS-ja më pas nuk ka bërë pyetje të tilla bazë hetimore
20 edhe në pyetjet e drejtpërdrejta për dëshmitarin. Mund të ketë
21 vetëm dy arsye se pse një prokuror i ZPS-së nuk bën pyetje
22 pasuese bazike, ose prokurori ka qenë shumë neglizhent që
23 mbase ka pak gjasa, ose ndoshta ZPS-ja e dinte ose prokurori i
24 ZPS-së e dinte që përgjigjet e Bashotës do të çonin në
25 nxjerrjen e materialit shfajësues.

1 ZPS-ja e di që deklarata e TPNJ-së e 2006 e Bashotës ka
2 pak besueshmëri.

3 Shohim diapozitivin 35.

4 Është dhe më pak e besueshme nëse shikojmë kontekstin kur
5 e ka dhënë këtë deklaratë. Sikurse e kam theksuar gjatë
6 kundërpyetjeve të mia, Bashota është kontaktuar nga të njohur
7 të ish-të akuzuarit Ramush Haradinaj përpara se është takuar
8 me ekipin hetimor të TPNJ-së. Më pas dha një narrativë që në
9 mënyrë hipotetike tregoi autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm
10 për ndalimet dhe ekzekutimet dhe jo në komandantët e zonave si
11 Haradinaj. Duke dhënë kështu informacion shfajësues për të
12 akuzuarin Haradinaj asokohe kur TPNJ-ja nuk kishte mundësi të
13 ngrinte akuza ndaj Bashotës apo kujtdo tjetër.

14 Në realitet, deklarata e 2006 e Bashotës nuk ishte aspak
15 e rrezikshme dhe nuk mund të dilte Prokuroria në përfundime të
16 tilla duke marrë parasysh strategjinë e TPNJ-së sepse ishte
17 thjesht dëshmi shfajësuese për Haradinajn në gjykimin e tij,
18 pra, ekipi hetimor i TPNJ-së nuk e thirri fare as si dëshmitar
19 Bashotën në këtë rast. Nuk kam ç'të shtoj më për këtë.

20 Tri diapozitivat e radhës nuk janë për publikun.

21 Tani dua të trajtoj dëshminë e Dëshmitarit W04489 dhe
22 problemin e shënimeve paraekzistuese të dëshmitarit.

23 Pretendimi doli të hënën për herë të parë se dëshmitari i ka
24 përgatitur shënimet përgatitore -- ia ka dhënë shënimet
25 përgatitore Trupit Gjykses me kërkesë të Mbrojtjes dhe si

1 rrjedhje "nacioni që dëshmitari do të gënjente për një
2 ngjarje në një shënim për veten në mënyrë që ta përdorte më
3 vonë si konfirmim kur u kërkuan këto shënime, në fakt, nuk
4 janë aspak të besueshme".

5 Ne kemi nevojë për kontekst. ZPS-ja pranon në
6 poshtëshënimin 3156 të dosjes së vet se Dëshmitari W04489 për
7 herë të parë e kishte ndryshuar dëshminë e saj në seancën
8 përgatitore me ZPS-në. Ajo i solli shënimet paraekzistuese
9 gjatë seancës përgatitore me ZPS-në. Mund të shikoni
10 transkriptin në faqen 11538. Dhe është e logjikshme të dalësh
11 në përfundimin se i ka përdorur këto shënime për ta ndihmuar
12 atë që të theksonte se çfarë donte t'i thoshte ZPS-së. Kjo nuk
13 është në mospërputhje me qëndrimin e Mbrojtjes.

14 Shohim diapozitivin 37.

15 Fakti që dëshmitari pretendonte se nuk e dinte kur i
16 kishte shkruar këto shënime dhe nuk mund të përjashtohet fakti
17 që mund të ketë shkruar dhe në 2023, avancon edhe më tej
18 qëndrimin e ZPS-së.

19 Diapozitivi 38.

20 Gjithashtu, ju thanë "se rrethanat se si u bënë këto
21 shënime provë materiale tregojnë indicie mbështetshmërie
22 veçanërisht duke mbajtur parasysh dëshmitarët e tjerë që kanë
23 marrë të njëjtin informacion nga i njëjti person. Është
24 interesante se pse ZPS-ja nuk na dha asnjë citim se kush
25 paskan qenë këta dëshmitarë që paskan marrë të njëjtin

1 informacion nga i njëjti person", kur u bënë pyetjet në lidhje
2 me shënimet ekzistuese. Kështu që ne mendojmë që për ne kjo
3 nuk ka qenë e paqëllimshme. Nuk i kam thënë citimet sepse nuk
4 kanë asnjë dëshmitar. Në fakt, sikurse ju thamë, dëshmitarët e
5 tjerë që dhanë dëshmi pretenduan se nuk e kanë dëgjuar
6 asnjëherë një informacion të tillë.

7 Shkurtimisht, tani, sa i takon kontributit që kërkohet
8 për NKP-në. Më duhet të flas edhe një herë për kontributin në
9 NKP sepse të gjithë jemi të prekur në lidhje me këtë. Por
10 duhet të them që ZPS-ja na ka akuzuar gjatë kundërargumenteve
11 që ne nuk jemi në gjendje të bëjmë "dallimin mes kontributit
12 për qëllimin e përbashkët dhe kontributin personal për secilin
13 nga krimet e akuzuara", dhe më pas shtuan që "kjo e fundit nuk
14 është kërkesë e jurisprudencave".

15 ZPS-ja citoi aktgjykimin Prlic për të thënë që "i
16 akuzuari nuk ka pse të kontribuojë në një krim konkret në
17 mënyrë që të ketë përgjegjësi penale për të ... sepse
18 kontributi në një NKP mund të ketë forma të ndryshme sikurse
19 dhe mund të jetë ekzekutimi i planit të përbashkët kriminal".

20 Ne jemi të bindur se po ta lexoni këtë paragraf të
21 aktgjykimit të Prlic do të shihni, në fakt, formulimin që ka
22 përzgjedhur ZPS-ja në mënyrë selektive në përgjigje të një
23 parashtrimi specifik të të akzuarit Stojic asokohe, i cili
24 argumentoi përpara apelit se Prokuroria duhet të demonstronte
25 lidhjen e drejtpërdrejtë mes ndihmës që kishte dhënë ai dhe

1 "krimeve individuale" që citoheshin në aktakuzë. Dhe në këtë
2 paragraf Dhoma e Apelit, në fakt, është mbështetur në
3 aktgjykimin e Krajisnik në paragrafin 659, ku është thënë që
4 për përgjegjësi penale për NKP nuk kërkohet që i akuzuari të
5 ketë kryer fizikisht apo të ketë marrë pjesë në *actus reus* të
6 krimit të kryer. Mjafton që i akuzuari të ketë kryer
7 veprimtari që në një mënyrë apo në një tjetër kanë ndikuar në
8 realizimin e NKP-së, çka do të thotë që të ketë dhënë
9 kontribut të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve që janë
10 pjesë e fushëveprimit të NKP-së.

11 Jemi në një rreth vicioz. Nuk kemi asnjë provë. Asnjëherë
12 nuk kemi thënë ne që ZPS-ja do të vërtetojë kontributin e
13 konsiderueshëm për secilën nga akuzat që gjenden në aktakuzë.
14 Por standardi që ka Dhoma e Specializuar që pasqyron
15 standardet e tribunalit është që duhet të ketë një kontribut
16 të konsiderueshëm për krimet në aktakuzë. ZPS-ja për këtë s'u
17 ka treguar asnjë provë.

18 Në përfundim, të nderuar Gjykatës, ju lutem shpallni
19 pafajësinë për të gjitha akuzat.

20 E shfrytëzoj këtë mundësi në shënimin tim përfundimtar,
21 të falënderoj të gjithë anëtarët e Trupit Gjykses, kolegët e
22 Prokurorisë, Ekipet e Mbrojtjes, Mbrojtësin e Viktimave, për
23 bashkëpunimin deri tani sepse kjo ka qenë norma në fakt dhe jo
24 përjashtimi i këtij gjykimi gati tri vjeçar.

25 Gjithashtu falënderoj stenografin, përkthyesit, Zyrën

1 Administrative, Zyrën e Mbrojtjes dhe të gjithë ata brenda dhe
2 jashtë sallës së gjyqit që na kanë ndihmuar. Ne e kemi
3 vlerësuar shumë kontributin tuaj.

4 Dua të falënderoj veçanërisht çdo anëtar të Ekipit të
5 Mbrojtjes së z. Thaçi që janë këtu dhe jo, sepse kontributi i
6 tyre ka qenë i vyer dhe kanë bërë një punë të shkëlqyer.

7 Ishte një kënaqësi, faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dixon, ju
9 keni gjysmë ore, kështu që ne nuk do të bëjmë pushim derisa të
10 mbaroni ju në mënyrë që të mos ju ndërpresim.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju duhet të
13 përfundoni si rregull rreth orës 10.40.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Faleminderit, të nderuar
15 Gjykatës.

16 Të nderuar Gjykatës, të hënën kur iu kundërpërgjigjëm
17 ZPS-së -- ZPS-ja kur foli të hënën e përmendi shumë pak z.
18 Veseli deri në momentin kur nga fundi z. Halling iu rikthye
19 dhe një herë trillimit të ZPS-së të ligjeve dhe fakteve për
20 një përpjekje të fundit për të përfshirë z. Veseli. Sipas nesh
21 deri në ato momente, nuk u tha asgjë, madje edhe kur thanë,
22 thanë fjalë boshe.

23 Asgjë deri në fund të fjalës së ZPS-së, sepse nuk kanë
24 asnjë përgjigje për akuzat që ngritëm ne sa i takon
25 argumenteve të tyre kundër z. Veseli. Por sidoqoftë, ata

1 pretendojnë se ne nuk kemi trajtuar "themelësinë", pra,
2 themelësinë e akuzave të ZPS-së. Është akuzë e rëndë kjo prej
3 ZPS-së sepse ajo që bëra unë javën e kaluar ishte pikërisht të
4 trajtoja çdo pretendim të tyre një e për një për t'u treguar
5 se ishin të pabaza. Edhe unë kisha edhe 500 diapozitiva të
6 tjerë që mund t'ua kisha prezantuar, mund t'ua kisha
7 paraqitur.

8 Kjo nuk është mbrojtje teknike nga ana jonë. Mbrojtja
9 mbështetet në të drejta më themelore që duhet të jenë në çdo
10 gjykim penal. Pra, e thënë shkurt, të testohen provat kundër
11 të akuzuarit, të kundërpyeten dëshmitarët. Duhet të ketë vlera
12 provuese të provave dhe në mënyrë të tillë që ne të kemi
13 mundësi t'i testojmë. ZPS-ja po përpiqet të shfrytëzojë
14 pikërisht fillin e artë të së drejtës penale për të lidhur
15 klientin tim. Ky parim ligjor është i padiskutueshëm. Gjykata
16 nuk mund të shpallë fajësinë për një person, qoftë kjo për
17 pjesëmarrje të drejtpërdrejtë apo të jesh pjesë e një plani të
18 përbashkët penal apo përgjegjësi eprore nëse kjo shpallje
19 fajësie do të mbështetet vetëm mbi prova të patestuara dhe mbi
20 thashetheme.

21 E zëmë se do të filloja unë të thoja që sikur, për
22 shembull, z. Pace është burimi dhe z. Pace më thotë mua se z.
23 Halling ka bërë diçka të paligjshme. Tani, në qoftë se z. Pace
24 e përdor këtë pretendim për një deklaratë dëshmitari apo
25 thjesht ma ka thënë apo poston diku apo çfarëdolloj mënyre,

1 nuk mund të dënohet z. Halling bazuar në thashethemin tim nëse
2 z. Pace nuk vjen në sallën e gjyqit për të dhënë vetë dëshmi
3 dhe që t'i bëhen pyetje. Nëse e bën atëherë është tjetër
4 situatë sepse testohet besueshmëria e z. Pace. Por situata
5 është e thjeshtë, të nderuar Gjykatës.

6 Po të fokusohemi në mënyrën e rrëmujshme se si është
7 përpjekur z. Halling ta zhbëjë parimin e shenjtë të së drejtës
8 penale në fjalët e fundit të ZPS-së lidhur me klientin tim.
9 Por, ne e kuptojmë pse po e bëjnë këtë. Sepse është e vështirë
10 për njeriun t'i harrojë zakonet e vjetra. Ai thotë "askush nuk
11 e diskuton se rregulla 140(4)(a) ... ka të bëjë me provat e
12 patestuara". Madje ai shtoi se pikërisht për këtë Paneli i
13 Apelit në rastin Shala shqyrtoi jurisprudencën e Gjykatës
14 Evropiane lidhur me dëshmitë e patestuara dhe madje tha lexoni
15 dhe paragrafin 486 të aktgjykimit.

16 Më pas bën një kthesë 360 gradë dhe thotë, po citoj:

17 "Po dispozita", pra, 140(4)(a), "në formulimin e vet të
18 qartë thjesht mbulon një nënkategori provash të patestuara,
19 gjegjësisht, deklaratat e dëshmitarëve të cilët Mbrojtja nuk
20 ka pasur mundësi t'i pyesë".

21 Dhe më pas thotë:

22 "Për çdo dëshmi tjetër që nuk është pjesë e deklaratave
23 të dëshmitarit", sidoqoftë e ka përkufizuar ky këtë, ne nuk e
24 dimë se si ka dalë ai në këtë përkufizim, atëherë vlen "parimi
25 i përgjithshëm i rregullës 139(3)."

1 Të nderuar Gjykatës, mbase e vutë re se ZPS-ja nuk na dha
2 aspak burime ligjore për këtë interpretim tërësisht të
3 trilluar të rregullës 140. Dhe ai në fakt nuk ju referoi ju që
4 të shikonit aktgjykimin në rastin Shala për këtë sepse ai
5 është i qartë aktgjykimi. Paragrafi 486, i njëjti paragraf që
6 ka cituar Prokuroria dhe çdo paragraf tjetër që ka cituar
7 Prokuroria para dhe pas u referohen rregullës 140(4)(a) e cila
8 mbulon të gjitha provat e patestuara pa një përjashtim të
9 vetëm. Kjo është rregulla e kësaj Gjykate.

10 Paragrafi 486 thotë që:

11 "... Trupi Gjykses interpreton rregullën 140(4)(a) ... si
12 një përjashtim për konfirmimin e shpalljes së pafajësisë
13 bazuar vetëm apo në mënyrë vendimtare në prova të patestuara,
14 pavarësisht nëse procesi gjyqësor në tërësinë e vet ka qenë i
15 drejtë apo jo."

16 Pavarësisht kësaj, por e rëndësishme është a janë
17 mbështetur në prova të patestuara si bazën e tyre për të dalë
18 në shpallje fajësie.

19 Për ne nuk mund të kishte qenë më e qartë se kaq. Paneli
20 i Apelit nuk e ngushton fushëveprimin e rregullës për një
21 nënkategori deklaratash të dëshmitarëve pa një përkufizim të
22 saktë. Ajo që duhet të kishte bërë ZPS-ja ishte që më së paku
23 të thoshte që këtë e ka thënë Paneli i Apelit por ne si
24 Prokurori nuk pajtohemi, apo mund të na jepte një argument
25 tjetër. Po jo, ata vijojnë më tej sikur të mos ekzistonte ky

1 interpretim. Se e kuptojmë që ligji për ta është i
2 pavolitshëm.

3 Dhe rregulla 139(3) që përmendi z. Halling po ashtu është
4 shumë e qartë. Nuk është në favor të ZPS-së kjo rregull. Në
5 fakt kjo rregull thotë që:

6 "Në varësi të rregullës 140(4)", pra, në varësi të kësaj
7 rregulle ombrellë, "Paneli nuk do të kërkojë kritere ligjore
8 për të cilat të kërkohej konfirmimi në mënyrë që të vërtetojë
9 krimet apo sjelljet kriminale ..."

10 Me fjalë të tjera, konfirmimi është gjithmonë në varësi
11 të rregullës 140(4), që ndalon pa përjashtim përdorimin e
12 provave të patestuara si bazën e vetme për të dalë me vendim
13 fajësie. Pra, këto dy rregulla duhen lexuar së bashku dhe të
14 zbatohen së bashku.

15 Tani, të gjitha argumentet kundër z. Veseli janë të
16 pabazura. Qoftë pretendimet e drejtpërdrejta si dhe
17 pretendimet rrethore. Për shembull, kur z. Halling të martën
18 ju tregoi një videoklip të Dëshmitarit W04760 kur po jepte një
19 intervistë për ZPS-në dhe tha që me demok kishte dëgjuar një
20 histori prej dikujt që klienti im ishte i përfshirë, ky është
21 thashethem i pastër sepse vetë burimi nuk ka qenë këtu në
22 mënyrë që të merrej në pyetje. Prandaj ky klip është krejt i
23 pavlerë. Sepse e ka përdorur Prokuroria thjesht se përmendet
24 emri i klientit tim, nuk mund të konsiderohet si provë. Dhe
25 nëse ju kujtohet, të nderuar Gjykatës, as nuk kam pasur

1 mundësi t'i bëj pyetje Dëshmitarit W04760 sepse unë kam
2 kërkuar të mos pranohej videoja e këtij dëshmitari. Dhe siç e
3 kemi shpjeguar në dosjen tonë, ne do ia kishim vërtetuar këtij
4 dëshmitari nëse do të merrte pjesë që ishte i pambështetshëm.
5 E njëjta gjë vlen dhe për pretendimet e tjera të përfshirjes
6 së drejtpërdrejtë dhe në lidhje me pretendimet e tjera
7 rrethimore të pabaza.

8 Ky nuk është një lloj procedurali që po bën Mbrojtja. Nuk
9 po luajmë. Ky është ligji kryesor për testimin e provave në
10 një gjykim penal, është një ligj që ka ekzistuar për dekada.
11 Por ne po themi që është ZPS-ja këtu, që po bën lojërat e veta
12 siç bën zakonisht.

13 Në fakt, ne e ftuam ZPS-në në duel. I thamë: A po na
14 thoni ju, për pretendimet e drejtpërdrejta, që mund të
15 mbështeteni në prova të patestuara për të dalë me vendim
16 fajësie thjesht sepse nuk është në formën e një deklaratë
17 dëshmitari sikurse e përkufizon kjo Gjykatë? Dhe ne po prisnim
18 që ata të kundërgumentonin dhe të na thonin që ju e keni
19 gabim, por s'e bënë. Z. Halling, po ashtu as nuk guxoi që të
20 paktën jepte ligjin e gabuar sa i takon përfshirjes së
21 drejtpërdrejtë dhe t'ju thoshte, të nderuar Gjykatës, kështu
22 mendojmë ne që ju, të nderuar Gjykatës, mund të dilni me
23 vendim fajësie, A, B, C. As këtë nuk guxuan ta bënin. Madje e
24 sot e kësaj dite nuk i kanë të qarta argumentet e tyre sepse e
25 dinë që janë të gabuara. Por ata shpresojnë që ju, të nderuar

1 Gjykatës, t'i bashkoni pikat për ta.

2 Por nuk keni si ta bëni ju këtë as nga pikëpamja ligjore
3 dhe as nga pikëpamja faktike. Sigurisht Mbrojtja nuk do që ju,
4 të nderuar Gjykatës, të mos jeni gjyqtarët, të "mos bëni punën
5 tuaj", se si pretendon ZPS-ja në një mënyrë të shëmtuar, por
6 Mbrojtja ju kërkon, të nderuar Gjykatës, që pikërisht këtë të
7 bëni, të bëni punën tuaj, të zbatoni ligjin më elementar.

8 Veç kësaj dhe prapë ZPS-ja nuk e pranon që është gabim,
9 ne i kemi trajtuar gjerë e gjatë makinacionet e grumbullit të
10 thashethemeve që ka ZPS-ja lidhur me pretendimet e
11 drejtpërdrejta dhe themelësia dhe themelësinë e argumenteve të
12 tyre që sipas nesh nuk ekziston fare. Shikoni ju lutem në
13 dosjen tonë paragrafët 233 dhe 248. Janë 15 faqe vetëm për një
14 pretendim ku kemi thënë se si provat bazuar në thashetheme
15 janë thjesht një grumbull mbeturinash që nuk vërtetojnë aspak
16 që z. Veseli të ketë qenë i përfshirë në ndonjë veprimtari, e
17 jo më të ketë qenë i pranishëm fizikisht kur diçka ka ndodhur.

18 Gjithashtu, nuk ekziston as ndonjë gjysmë sugjerim për
19 një kundërshtim të rregullës 155 e cila mund të merret si
20 faktor relevant për shqyrtimin e këtyre provave. Unë nuk e
21 kuptova qartësisht se çfarë po përpiqej të thoshte ZPS-ja në
22 fakt, po më duhet të theksoj se Mbrojtja e Veselit e ka
23 kundërshtuar qartë pranimin e dokumenteve sipas rregullës 155,
24 si për rastin e Dëshmitarit W04747 dhe në rastin e Dëshmitarit
25 W04760 që sapo e përmenda, si dhe për Dëshmitarin W04839. Ky

1 është i vetmi dëshmitar që ka folur për ndalimet në Kleçkë.
2 Dhe në këtë drejtim ju lutem mund të shikoni një parashtrim
3 tonin të 4 dhjetorit 2025, paragrafin 4, ku kemi thënë se e
4 kundërshtojmë pranimin e deklaratës së Dëshmitarit W04670
5 sepse cenon qartazi rregullat 155 dhe 138. Dhe ne madje
6 kërkuam dhe ta apelonim vendimin mbi bazës se është
7 jorelevante. Është thjesht dëshmi bazuar mbi thashetheme, nuk
8 është provë kryesore.

9 Ndërsa sa i takon Dëshmitarit W04747, kundërshtimi ynë
10 për mospranimin e kësaj prove, po ashtu, bazohet në të drejtën
11 e të akuzuarit për t'i bërë kundërpyetje dëshmitarit. Fakti që
12 u pranua prova nuk e ndryshon rregullën, dhe kjo provë nuk
13 mund të merret për bazën në rast se nuk konfirmohet dhe,
14 sigurisht, që nuk ndryshon gënjeshtret e shumta që ka thënë ky
15 dëshmitar. Të nderuar Gjykatës, ne nuk duam që as të trajtohet
16 më tej kjo provë, siç e kemi cituar në poshtëshënimin 62 të
17 dosjes sonë për të kuptuar që ky person ka gënjyer haptazi. Ju
18 lutem shikoni dosjen tonë në paragrafin 54, ku kemi ilustruar
19 një shembull të gënjeshtreve që tashmë janë bërë pjesë e
20 provave gjyqësore si, për shembull, pretendimi se ka luftuar
21 për ushtrinë në një shtet tjetër, s'e ka bërë, e sajoi, e
22 shpiku këtë gjë. Shikoni paragrafin 56 të dosjes sonë sa i
23 takon mospërputhshmërive të brendshme dhe kontradiktave në
24 dëshminë e këtij personi.

25 Lista e plotë e gënjeshtreve të tij të plota që janë

1 pjesë e provave gjyqësore, janë renditur edhe më tej në
2 dokumentin F3147 dhe shtojcave përkatëse. Dhe po e them dhe
3 një herë pretendimet e tij të pabesueshme janë krejtësisht të
4 pakonfirmuara. Shihni paragrafin 55 të dosjes sonë.

5 E njëjta gjë vlen dhe për rastin e Dëshmitarit W04839 që
6 ju thamë, është një dëshmitar që flet për Kleçkën. Është një
7 gënjeshtar i njohur. E kemi përmendur këtë edhe në paragrafin
8 601 të dosjes sonë.

9 Prandaj, ne mendojmë z. Halling nxitoi të hënën kur tha
10 që ne as nuk u shqetësua ta shpjegojmë se si do ta trajtonim
11 dëshminë e dëshmitarit nëse ai do të merrte pjesë në sallën e
12 gjyqit dhe do të jepte dëshmi. Arsyeja pse iu referuam
13 deklaratave që nuk janë pjesë e provave gjyqësore në
14 poshtëshënimin 62 është pikërisht për të theksuar dëmin e madh
15 që i është bërë Mbrojtjes për faktin që dëshmitari nuk ka qenë
16 i pranishëm fizikisht për të dhënë dëshmi. Jo për vërtetësinë
17 e dëshmisë së tij. Po për dëmin që na është bërë ne, sepse
18 ZPS-ja nuk thirri askënd tjetër nga zona e tij. Dhe do të
19 shihni që ka deklarata që janë marrë ndër të tjera dhe nga
20 komandantët e zonës së tij, komandantët e brigadës së tij -
21 të cilët mund t'i kishte intervistuar ZPS-ja - madje dhe një
22 grup luftëtarësh në zonën e tij për të cilët ai ngre
23 pretendime të trilluara.

24 Por dëshmia e këtij personi është e patestuar dhe e
25 pakonfirmuar, e për rrjedhojë, nuk mund të përdoret për të

1 dalë me vendim fajësie dhe prandaj ne nuk i thirrëm këta
2 persona si dëshmitarë. Se barra e provës nuk është e jona.

3 Edhe në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit W04747 ku u
4 pretendua se ai kishte frikë të vinte këtu. Ai është i vetmi
5 burim dhe nuk është e vërtetë dhe duhet parë në kuadër të të
6 gjitha gënjeshtreve që ka thënë ky person. Një deduksion
7 tjetër ky i qartë se pse ky person nuk ka dashur të vijë se
8 ishte i frikësuar prej gënjeshtreve që ka thënë, sipas nesh,
9 dhe do të ekspozohet për ato që ka thënë.

10 Tani çfarë tha z. Halling të hënën për konfirmimin dhe
11 NKP-në? Në fakt, ZPS-ja ka goditur objektivin e gabuar dhe të
12 bën në fakt të tundësh kokën me argumentet e tyre. Dhe kam tre
13 pika të shkurtra që dua t'i trajtoj në lidhje me këtë.

14 Së pari, ZPS-ja tha se konfirmimi kërkohet vetëm në
15 kuadër të rregullës 140(4)(a) për të kuptuar panoramën e plotë
16 si *mens rea*, për NKP-në. Kjo është tërësisht e gabuar. Ua
17 thashë dhe javën e fundit, Paneli i Apelit Shala i prapësoi
18 konstatimet lidhur me torturat jo për përfshirjen e të
19 akuzuarit vetëm, pra, disa nga këto akuza i rrëzoi vetëm mbi
20 bazën se ishin të mbështetura në thashetheme. Konstatimet
21 duhet të jenë në pajtim me rregulloren.

22 Së dyti, ZPS-ja tha se nuk ekziston asnjë kriter për
23 konfirmimin e këtij fakti konkret. Por pikërisht këtë ka bërë
24 Paneli i Apelit në vendimin lidhur me Dëshmitarin W04747 në
25 paragrafin 36. Pikërisht këto fakte renditën. Mund të ketë

1 prova të ndryshme por faktet duhet të mbeten të njëjta.

2 Z. Halling përmendi rastet që ka cituar ZPS-ja në këtë
3 apel, po humbi thelbin e këtij vendimi. Sipas ZPS-së, asokohe
4 ajo që mund të kishte bërë z. Veseli diku tjetër në Kosovë, në
5 një periudhë tjetër kohore, çfarëdolloj gjëje të ketë qenë kjo
6 mund të përdorej e kombinuar me provat e patestuara të
7 përfshirjes së drejtpërdrejtë të pretenduar si, për shembull,
8 në lidhje me transferimin e një personi të vetëm, për të
9 mbështetur pretendimin se ai ka dhënë kontribut për NKP-në.
10 Pra, të përdoren të gjitha provat e patestuara lidhur me
11 përfshirjen e drejtpërdrejtë dhe të lidhen së bashku me ca
12 prova të tjera dhe të dilet me konstatimin që mbështet
13 ndërmarrjen kriminale të përbashkët, kjo është absurde.
14 Prokuroria as nuk është përpjekur t'ua tregojë se si ta bënit
15 bashkë ju këtë mozaik. Çdo fakt është i nevojshëm për të dalë
16 me vendime fajësie dhe çdo fakt duhet të jetë i konfirmuar.

17 Të përdori rastin e një personi që është transferuar, të
18 nderuar Gjykatës, shikojeni se çfarë citohet, provat që janë
19 cituar prej ZPS-së për t'ua përpjekur të tregojnë që z. Veseli
20 ka qenë në zonën e përgjithshme, por asnjë provë nuk e tregon
21 konkretisht ku ka qenë në këtë datë konkrete dhe nuk ka qenë
22 fare në këtë zonë në këtë kohë. Ata nuk mund ta bëjnë këtë për
23 të thënë që mund të vërtetojmë ne NKP-në thjesht sepse
24 mendohet që ka qenë diku në zonë në mënyrë të përgjithshme.

25 Së treti, të nderuar Gjykatës, ZPS-ja thotë që Mbrojtja e

1 ka minimizuar kontributin tjetër të z. Veseli që e kanë
2 anashkaluar. Por nuk tregojnë në mënyrë të posaçme se për
3 çfarë kontributesh bëhet fjalë.

4 Të nderuar Gjykatës, do t'ju kujtohet që unë i trajtova
5 dy pretendimet kryesore të drejtpërdrejta. Dhe të tjerat për
6 të cilat u përmendën dhe ne nënvijëzua dëshmitë e
7 pakundërshtuara që z. Veseli ka qenë jashtë shtetit për një
8 kohë shumë të gjatë nga fundi i korrikut deri në shtator dhe
9 tetor, periudha kur ishin negociatat me FARK-un e më pas nga
10 12 nëntori 1998 deri në mars të 1999 pas Rambujesë, dhe nuk ka
11 patur asnjë provë të mbështetshme që të tregojë që ai të ketë
12 qenë në kontakt me persona në Kosovë gjatë kësaj periudhe të
13 gjerësishme. Shikoni paragrafin 520 të dosjes sonë
14 përfundimtare për të parë këtë vijimësi kohore dhe paragrafin
15 mbështetës.

16 Edhe kur ndodhej në Kosovë, siç kemi thënë, z. Veseli ka
17 marrë pjesë në shumë pak takime dhe ka shkuar shumë rrallë në
18 Shtabin e Përgjithshëm. Nuk ka komanduar ndonjë strukturë
19 funksionale të inteligjencës apo askënd, në fakt. Dhe nuk ka
20 qenë as aktiv në kuadrin e drejtorisë politike, madje as
21 anëtarësia e tij në këtë drejtori nuk është provuar, pasi
22 burimi është nga prova të pavërtetuara. Shikoni paragrafin 298
23 të dosjes sonë për këtë.

24 Megjithëkëtë, nuk ka prova që z. Veseli të ketë vepruar
25 në kuadrin e kësaj drejtorie në asnjë farë mënyre dhe aq më

1 pak që të ketë kontribuar me synimin e një NKP-je që të ketë
2 patur njohuri për krimet e kryera në atë kontekst.

3 Ne nuk po i shmangemi rolit tonë siç pretendon ZPS-ja apo
4 që t'i largohemi asaj që është në fakt dhe që karakterizon z.
5 Veseli. Ne po tregojmë që ai nuk ka patur role kriminale. Ai
6 ka patur role të cilat nuk kanë qenë kriminale. Dhe prandaj,
7 ZPS-ja nuk mund të pretendojë që ne këtu nuk po trajtojmë edhe
8 thelbin e çështjes.

9 Megjithëkëtë, duke qenë që ne jemi marrë me themelet e
10 kësaj çështjeje, pasi fola që ka qenë jashtë shteti, ZPS-ja u
11 hodh dhe tha se z. Veseli në fakt ka qenë në një veprimtari të
12 drejtpërdrejtë në muajt e parë të aktakuzës kur po krijohet
13 edhe komanda përpara se të ishte që të mungonte nga Kosova.
14 Dhe është hera e parë, do të thonim ne, që ZPS-ja pranon të
15 hënën, që të përqendrohet në çështjen e komandës dhe
16 kontrollit në muajt e hershëm. Mirëpo, në atë kohë niveli
17 organizativ ishte në fazën fillestare dhe ishte periudha më e
18 paorganizuar. Dhe kjo në fakt është dhe kulmi i
19 horizontalizmit. Nuk ka sigurisht asnjë provë të ekzistencës
20 të ndonjë strukture të inteligjencës në atë kohë, drejtoritë u
21 krijuan vetëm më vonë, nga nëntori i 1998-s, bazuar në provat
22 dhe edhe atëherë nuk ka patur përqendrim apo lidhje me zonat.
23 Kjo është periudha që përkon me largimin jashtë shtetit të z.
24 Veseli.

25 Përpara se të përfundojmë, të nderuar Gjykatës, deshëm

1 t'i ktheheshim pyetjes së Gjykatësit Barthe lidhur me
2 praktikën shtetërore për të mbështetur të drejtën zakonore të
3 ndalimit për arsye të sigurisë. Është një aspekt shumë i
4 rëndësishëm, pasi siç mund ta dini, të nderuar Gjykatës dhe
5 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin e pjesës detare
6 të Detit të Veriut e ka bërë të qartë. Ne mund të jemi
7 pikërisht në këtë fushë të praktikës shtetërore dhe jemi
8 dakord këtë, por ne nuk mund të mos kemi arritur në këtë
9 praktikë shtetërore, por nuk jemi as për ekzistencën e krimit
10 të paraburgosjes së paligjshme në kohën e një konflikti të
11 armatosur sipas të drejtës zakonore. Apeli i Shalës e ka
12 pranuar që parandalimi, privimi i lirisë mund të ndodhë për
13 arsye të sigurisë. ZPS-ja duhet ta aprovojë që në mënyrë të
14 arsyetueshme që ndalimi të ketë qenë i domosdoshëm tërësisht,
15 duke iu referuar jurisprudencës së TPNJ-së. Ne kemi përmendur
16 jurisprudencën përkatëse në paragrafët 724 deri në 734.
17 Konsultimet e ekspertëve të Kryqit të Kuq dhe analizat e
18 çështjeve përkatëse konfirmojnë këtë duke iu referuar
19 legjislacionit të vendeve përkatëse, manualeve ushtarake dhe
20 praktikave shtetërore të shteteve dhe të organizatave
21 ndërkombëtare. Dhe, të nderuar Gjykatës, ju referoj studimit
22 të së drejtës zakonore të Kryqit të Kuq, rregulli 99 mbi
23 privimin e lirisë, Volumi I, rregullorja dhe *Chatham*
24 *House*/Raporti i Ekspertëve i Kryqit të Kuq i takimit të 2009-
25 *s*, 91 Revista Ndërkombëtare *Internacional Review of the Red*

1 Cross faqe 859.

2 Si përfundim, të nderuar Gjykatës, ZPS-ja në fund të
3 parashtrimeve të saj të hënën tha se ne jemi duke përçarë dhe
4 sunduar kur bëhet fjalë për vlerësimin e tërësisë së provave.
5 Edhe një herë është një metaforë ironike që shoqërohet me
6 punën kundër nesh. Megjithëkëtë edhe më e rëndësishme është që
7 nuk është me motive të qarta pasi Mbrojtja ka të drejtë që të
8 tregojë që pretendimet, thelbin të bazuar në thashetheme dhe
9 janë të pavërtetuara dhe të pabaza dhe ajo që mbetet janë
10 thjesht thërrime thashethemesh.

11 Ku në tërë këtë univers provash janë në fakt argumentet
12 për veprimtari kriminale të z. Veseli? ZPS-ja nuk na ka
13 treguar asnjë udhërrëfyes. Jua lanë juve, të nderuar Gjykatës,
14 që të mund ta hartoni një gjë të tillë. Sipas mendimit tonë,
15 kjo është dembellëk dhe tregon përbuzje për vetë themelin e
16 kësaj Gjykate e cila nuk është krijuar për të dënuar për hir
17 të dënimit, dhe kjo nuk bëhet thjesht sepse tregohet thjesht
18 një model reklamimi dhe në fakt ky është edhe rregulli kryesor
19 i përçarjes dhe sundimit. Të kontrollohen narrativat e rreme
20 duke fragmentarizuar të vërtetën. Gjykata ka nevojë që të
21 gjejë të vërtetën në të gjithë këtë rrëmujë, që të gjejë që
22 nuk ka asnjë provë në argumentet e ZPS-së dhe ky trup gjykues
23 të bashkohet rreth së vërtetës lidhur me pafajësinë e z.
24 Veseli.

25 Të nderuar Gjykatës, kaq kisha.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 z. Dixon.

3 Tani do të bëjmë pushim deri në orën 11.00 për të dëgjuar
4 dy parashtrimet e fundit të Mbrojtjes së Selimit dhe Mbrojtjes
5 së Krasniqit. Pastaj do të marrim pushimin e drekës dhe pas
6 drekës do të dëgjojmë deklaratat e të akuzuarve.

7 Ellis.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse ju ndihmon
9 unë nuk do të shfrytëzoj të tëra 30 minutat. Do të kem rreth
10 20 minuta në dispozicion.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të njëjtin
12 plan pune do të ndjekim. Jemi mirë me kohën deri tani.

13 Kështu që tani do të takohemi sërish në orën 11.00. Deri
14 atëherë e pezullojmë seancën.

15 --- Pauza fillon në orën 10.40

16 --- Seanca rifillon në orën 11.00

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përkthyesit
18 më njoftuan që kam bërë një gabim për pushimin e drekës, kur
19 të mbarojmë me këto dy parashtrime do të bëjmë një pushim deri
20 në orën 1.30 për drekë, pas pushimit të drekës, do të kemi
21 parashtrimet e pasdites, fjalët e të akuzuarve. Sigurisht që
22 përkthyesit duhet të kenë kohën që u është caktuar, edhe
23 sigurisht nuk duhet të ndikojmë tek orari i drekës.

24 Ju kërkoj ndjesë për gabimin, kam folur unë gabim s'e kam
25 menduar e kam thënë pa dashje.

1 Në rregull, vazhdojmë tani. Fjalën e ka Mbrojtja e z.

2 Selimi.

3 Z. Roberts, fjala është për ju.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

5 Të nderuar Gjykatës, kjo është mundësia ime e fundit të
6 bëj parashtrime në këtë çështje gjyqësore për t'iu
7 kundërpërgjigjur parashtrimeve gojore të ZPS-së. Të jem i
8 singërtë siç dhe kemi bërë deri tani, unë kam një problem. Nuk
9 ka asgjë në parashtrimet e Prokurorisë të cilave mund t'u
10 kundërpërgjigjem. Pavarësisht se më keni dhënë dy orë e gjysmë
11 për parashtrimet, Prokuroria me argumentet dhe pretendimet e
12 veta në përgjigje të argumenteve tona tha disa vetëm disa pika
13 diskrete që ne i kemi trajtuar shumë më parë.

14 Ta themi troç, Prokurorisë vetë i vjen turp për
15 argumentet e veta kundër z. Selimi. Nuk mund të dilet në asnjë
16 përfundim tjetër, si nga parashtrimet e të hënës apo dosja e
17 tyre me shkrim. Nëse vetë Prokuroria nuk është bindur për
18 argumentet e veta kundër z. Selimi, si mund t'ju bindë ju?

19 Sidoqoftë, dua të trajtoj disa nga këto pikat diskrete që
20 burojnë nga parashtrimet e Prokurorisë, jo sepse mendojmë se
21 kanë vlerë për argumentet e Prokurorisë, por sepse cenojnë
22 vlerat themelore dhe tregojnë mangësi ligjore në argumentet e
23 tyre.

24 Së pari, pavarësisht parashtrimeve të hollësishe që kemi
25 bërë për çdo aspekt të elementit të ndërmarrjes kriminale të

1 përbashkët, që nga anëtarësia e pretenduar, objektiva në
2 thelb, mjetet e pretenduara përmes të cilave realizohet ky
3 objektiv, e vetmja gjë që tha Prokuroria është që provat
4 lidhur me ngjarjet e përmendura në komunikata gjenden në
5 poshtëshënimin 6206 të Prokurorisë. Por në fakt, ky
6 poshtëshënim thjesht përsërit pretendime në komunikata dhe nuk
7 evidenton asnjë provë që të mbështesë këto pretendime, apo që
8 këto ngjarje kanë ndodhur në të vërtetë. Kjo nuk është provë
9 bazë, por është thjesht përsëritje e pretendimeve në
10 komunikata. Paaftësia e Prokurorisë për të bërë dallimin mes
11 pretendimeve dhe provave është po aq shqetësuese në këtë fazë
12 të procesit gjyqësor sa ç'është dhe befasuese. Por madje dhe
13 paaftësia për të trajtuar pikat e tjera që janë ngritur në
14 lidhje me NKP-në, theksojnë mungesën e qartësisë dhe besimit
15 që ka vetë Prokuroria në argumentet e veta.

16 Për t'iu përgjigjur parashtrimeve të shumta që janë bërë
17 në lidhje me irelevancën e frazës "luftë speciale" Prokuroria
18 në vija të përgjithshme thotë që po ky i akuzuar e ka përdorur
19 këtë term, dhe iu referua një fjalimi të zotit fjalimi [Sipas
20 përkthimit] kur ka marrë pjesë në ngjarjen e parë publike të
21 UÇK-së në nëntor të 97-s. Por kjo frazë nuk është përdorur
22 aspak nga z. Selimi gjatë fjalimit dhe nuk është evidentuar
23 asnjë rast ku ai ta ketë përmendur konkretisht këtë frazë. Të
24 gjitha dokumentet e tjera që ka cituar Prokuroria në Gjykatë
25 në lidhje me këtë koncept kanë kaq shumë mangësi provuese saqë

1 Trupi Gjykses nuk duhet të bazohet kurrsesi mbi to.

2 Si zakonisht, ju lutem të shqyrtoni çdo dokument të vetëm
3 të cilin ka përdorur Prokuroria për të shkruar dhe për t'u
4 përgjigjur gojarisht në mënyrë që të dilni në përfundimin nëse
5 pretendimet e tyre të dobëta janë të besueshme. Sipas nesh nuk
6 janë aspak të besueshme për secilën nga akuzat.

7 Sa i takon rolit të inspektorit të përgjithshëm,
8 Prokuroria pretendon se ndonëse z. Selimi nuk ka pasur
9 autoritet formal sipas rregulloreve disiplinore kjo s'ka
10 rëndësi, sepse këto rregullore mesa duket në përgjithësi
11 autorizojnë eprorët të marrin masa disiplinore. Prokurori po
12 ashtu pretendoi se Zyrapit ka dhënë dëshmi dhe ka thënë se
13 inspektori përgjithshëm kishte autoritet të pakufishëm për të
14 ushtruar kontroll, dhe iu referua një shkresë konceptuale ku
15 thuhej se një nga përgjegjësitë e inspektorit të përgjithshëm
16 ishte të evidentonte "mangësi".

17 Vërtetë kaq ka Prokuroria? A mundet që argumentet e
18 Prokurorisë në lidhje me autoritetin disiplinor të z. Selimi
19 të mbështeten në themele kaq të përgjithshme, dhe të lëmë
20 mënjatë të gjithë pjesën tjetër të dëshmisë së z. Zyrapit dhe
21 të gjitha provat e tjera të dëshmitarëve të tjerë? A mos po e
22 bëjnë këtë duke shpresuar që ju, të nderuar gjykatës, këtë nuk
23 do ta vini re? Sepse mesa duket këtë po bëjnë.

24 Sa i takon shënime me shkrim dore, Prokuroria iu referua
25 parashtrimeve të Mbrojtjes si një përpjekje për ta shfrytëzuar

1 si ekspertizë procesin e vërtetimit të autorësisë së këtyre
2 shënimeve. Por, mesa duket ka harruar diçka Prokuroria, që
3 barra është e Prokurorisë që të demonstrojë dhe të vërtetojë
4 atribuimin e këtyre shënimeve për z. Selimi. Prokuroria nuk
5 thirri një dëshmitar të vetëm fakti që të identifikonte ndonjë
6 pjesë shënimi kaligrafie nga shënimet që tani Prokuroria
7 pretendon se janë të z. Selimi. Nuk mund t'i vendoset barra e
8 provës Mbrojtjes sa i takon autorësisë, bazuar në provat që
9 tashmë i keni pjesë të dokumentacionit gjyqësor, të nderuar
10 Gjykatës.

11 Aktgjykimi Sesay, paragrafi 517 e ka qortuar Mbrojtjen
12 pse nuk thirri aktekspertiza kur dëshmitarët e faktit kishin
13 krijuar, në fakt, kishin nxjerrë akuza kundërprovuese. Po nuk
14 jemi në këtë situatë në këtë çështje gjyqësore. Në raste kur
15 Prokuroria dëshiron të përcaktojë autorësinë pa dëshmitarë
16 fakti, më së paku duhet të paraqesë të gjitha provat në mënyrë
17 që të vërtetojë autorësinë, që sipas, nesh në këtë rast mund
18 të ishte bërë vetëm përmes aktekspertizave. Por, Prokuroria
19 qëllimisht nuk e bëri këtë gjë.

20 Të kritikosh parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes në
21 lidhje me këto dokumente me shkrim dore është gabim nga ana e
22 Prokurorisë, sepse Prokuroria përpiqet ta vendosë Mbrojtjen
23 dhe Prokurorinë në të njëjtën anë. Po ka një dallim të qartë
24 mes palëve dhe barrës që ka secila palë. Dhe për këtë qëllim
25 ne kemi bërë dhe parashtrimet përkatëse. Nuk mundet Prokuroria

1 të thotë që thjesht ka ngjashmëri dhe jongjashmëri në
2 kaligrafi, siç pretendon. Dhe, Prokuroria i kërkon Trupit
3 Gjykses në këtë fazë të vonë të gjykimit të shikojë blloqet e
4 shumta që ka përdorur Prokuroria, dhe të dalë Trupi Gjykses në
5 përfundimin sa i takon autorësisë së z. Selimi. Dhe ky është
6 një problem material që duhet shqyrtuar në vendimin e
7 fajësisë. Në këto rrethana Prokuroria duhet ta kishte bërë të
8 qartë që në fillim çfarë provash kishin në lidhje me
9 atribuimin e këtyre blloqeve të shënimeve për z. Selimi, dhe
10 më pas të jepte të gjitha provat për të mbështetur pretendimet
11 e veta. Nuk e ka bërë këtë gjë.

12 Trupi Gjykses nuk duhet t'i pranojë këto thirrje
13 dëshpëruese të fazës së fundit të Prokurorisë në mënyrë që të
14 justifikojë paaftësinë e tyre. N

15 Në lidhje me akuzat individuale në lidhje me kontributin
16 kundër z. Selimi, Mbrojtja bëri parashtrime të thelluara sa i
17 takon besueshmërisë, mbështetshmërisë së dëshmitarëve,
18 kontradiktave mes dëshmive të tyre dhe mungesës së provave,
19 qoftë nëse këto prova ishin në favor apo jo të z. Selimi.

20 Përgjigja nga Prokuroria cila që në lidhje me këto
21 parashtrime? Thanë që nuk do tërhiqen nga akuzat në lidhje me
22 Qirezin për z. Selimi. Sidoqoftë, edhe për këtë aspekt
23 konkret, ju ftojme, të nderuar Gjykatës, të shqyrtoni
24 pretendimet që ka pasur Prokuroria në dosjen paraprake kundër
25 z. Selimi, dhe ju lutem, krahasoni parashtrimet dhe këto

1 pretendime me këto që kanë ngritur Prokuroria në fund të
2 çështjes gjyqësore. Mund ta shikoni vetë se si Prokuroria e ka
3 ndryshuar narrativën e vet.

4 Sa i takon kontributeve të pretenduara të konsiderueshme
5 të z. Selimi në NKP, është shqetësuese heshtja e Prokurorisë.
6 Prokuroria shumë thjesht nuk iu kundërpërgjigj kundërshtimeve
7 që bëri Mbrojtja në lidhje me pretendimet e tyre dhe
8 pretendimet -- provave të tyre sa i takon kontributit të
9 pretenduar të z. Selimi në NKP. Dhe nuk ka asnjë detyrim
10 Mbrojtja për të shtjelluar më tej në lidhje me këtë pikë.

11 Sidoqoftë, Prokuroria trajtoi aspektin juridik të natyrës
12 së këtij kontributi, pra sa i takon ndërmarrjes kriminale të
13 përbashkët - mund të shikoni transkriptin e të hënës, është
14 faqja 29136 - çështja nuk është nëse i akuzuari drejtpërdrejtë
15 shkaktoi secilin nga krimet për të cilat akuzohet, por nëse
16 sjellja e tyre në mënyrë të konsiderueshme avancoi më tej në
17 ndërmarrjen kriminale për të cilën akuzohen.

18 Askush nuk ka pretenduar se kontributi duhet të ketë
19 shkaktuar drejtpërdrejtë krime në mënyrë që të merret parasysh
20 për qëllimet e përgjegjësisë penale NKP, por kjo është një
21 shpërqendrim i qëllimshme nga Prokuroria. Ajo që ka rëndësi
22 është që kontributi i pretenduar duhet të ketë kontribuar në
23 mënyrë të drejtpërdrejtë në krimet për të cilat akuzohen. Këtë
24 çështje e shtjelloi z. Misetic më herët.

25 Dhe ne mendojmë që Prokuroria po përpiqet që në mënyrë

1 artificiale të ndajë objektivën e ligjshme që është në thelb
2 të NKP-së nga krimet të cilat po akuzohen, duke pretenduar se
3 në këtë formë u realizua ky objektiv, në këtë mënyra. Pra për
4 ne kjo nuk është e mjaftueshme për përgjegjësi penale,
5 absolutisht nuk është.

6 Objektiva e NKP-së nuk është tërësisht kriminale dhe mund
7 të jetë përgjegjësi penale për NKP, nëse është kryer përmes
8 mjeteve të paligjshme. E kemi trajtuar këtë me hollësi javën e
9 kaluar. Prandaj qëllimi kriminal në tërësinë e vet përfshin si
10 objektiven dhe mjetet kriminale të pretenduara. Të nderuar
11 gjykatës, nuk mund t'i ndani në mënyrë artificiale. Realizimi
12 i ndërmarrjes kriminale kërkon rrjedhimisht që i akuzuari të
13 ketë kontribuar drejtpërsëdrejti në krimet në fjalë.

14 Ne po themi që kjo është një nga shumë rastet që e
15 ilustron se Prokuroria nuk ka argumente kundër z. Selimi.
16 Kontributi që pretendohet se ka dhënë z. Selimi në NKP, të
17 cilën e kemi trajtuar me hollësi me shkrim dhe me gojë, nuk
18 mund të vërtetohet se ka kontribuar në krimet e paraqitura në
19 aktakuzë. Për rrjedhojë, nuk mund të merret vendim fajësie
20 kundër z. Selimi në lidhje me NKP-në.

21 Kaq. Prokuroria nuk ka më asnjë provë. Asgjë nuk mund të
22 nxjerrë Prokuroria tani për të siguruar vendimin e fajësisë
23 kundër z. Selimi. Për secilin nga pretendimet që ka pasur
24 Prokuroria kundër z. Selimi në këtë rast gjyqësor, këto kanë
25 qenë të pabaza.

1 Kemi pesë vite me procedura paragjyqësore dhe gjyqësore,
2 kemi dëgjuar me qindra dëshmitarë, kemi me mijëra prova
3 materiale, dhe Prokuroria ka pasur tërësisht barrën e provës
4 në këtë çështje gjyqësore dhe është e logjikshme që të hënën
5 Prokuroria të kishte shkëlqyer. Sidoqoftë, siç e pamë të hënën
6 pasdite, ata me zor ja dolën mbanë.

7 Ajo që mund të bëj unë tani është thjesht të përsëris
8 kërkesën e javës së shkuar. Z. Selimi duhet të shfajësohet për
9 të gjitha akuzat, të lirohet menjëherë, të kthehet në Kosovë
10 pranë familjes së tij. Asnjë vendim tjetër nuk mund të
11 justifikohet në bazë të provave që janë paraqitur në këtë
12 çështje gjyqësore.

13 Ju faleminderit. U përpoqa të flisja shkurt. Këto ishin
14 parashtrimet tona. Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
16 z. Roberts.

17 Tani do të kalojmë te komentet e Mbrojtjes së Krasniqit.
18 Z. Ellis, është për ju fjala.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

20 Edhe unë do jem relativisht shkurt në parashtrimet tonë
21 sepse ne i qëndrojmë argumenteve të dhëna në dosjen
22 përfundimtare dhe në argumentet përmyllëse. Pjesa dërmuese e
23 të cilave nuk u prekën fare nga Prokuroria të hënën.

24 Ne parashtrojmë që vetëm tri pika të caktuara të ngritura
25 nga Prokuroria meritojnë të trajtohen në kundërpërgjigjen time

1 sot.

2 Pika e parë ka të bëjë me rolin e Bislam Zyrapi.

3 Të hënën, edhe një herë, Prokuroria u mundua që të
4 minimizonte rolin e Bislam Zyrapi, dhe që të mbështetet
5 gabimisht në parashtrimin që në nëntor të '98-s Bislam Zyrapi
6 ishte vartës i z. Krasniqi. Argumentet e Prokurorisë edhe
7 kësaj here vazhdojnë që të karakterizohen nga selektivitet dhe
8 përzgjedhje e vazhdueshme. Edhe në përgjigjen me gojë të
9 hënën, Prokuroria përzgjodhi fragmente që i shkojnë për shtat
10 teorisë së saj, ndërkohë që nuk mori parasysh fare sqarimet me
11 gojë si dhe dëshmi shfajësuese të pa kundërshtuara nga vetë
12 dëshmitarët e Prokurorisë. Kjo nuk është analizë. Kjo është
13 shtrembërim. Trupi Gjykses nuk duhet të orientohet drejt
14 preferimit të fragmenteve të përzgjedhura nga dokumente me
15 shkrim dhe të mos marrë parasysh dëshmi të dhëna nën betim
16 përpara Trupit Gjykses. Ta bësh një gjë të tillë do të thotë
17 që të kundërshtosh të gjithë hierarkinë e provave.

18 Pra, më konkretisht Prokuroria të hënën u mbështet në
19 faqe të caktuara të provës P189.1 pa pranuar që disa prej vetë
20 faqeve të cituara prej saj janë pranuar si nga Bislam Zyrapi
21 dhe Sokol Bashota si gabime dhe zmadhime ose ekzagjerime sa i
22 takon dëshmisë së tyre lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e
23 Shtabit të Përgjithshëm. Kjo jepet më konkretisht në
24 transkript në faqet 18400 deri në 18402, dhe në transkriptin e
25 Bashotës 23029, 23031.

1 Më pas Prokuroria mbështetet në provën P712 që është
2 diagrami që është ndërtuar apo është bërë nga Sadik
3 Jalitjahaj. Po çfarë të bën përshtypje është që ky diagram
4 identifikon Sokol Bashotën si zëvendëskomandant dhe e
5 përshkruan rolin e Krasniqit si zëvendës për mbështetje. Dhe
6 në asnjë vend nuk thuhet që z. Krasniqi ka qenë epror i z.
7 Zyrapi. Kështu provat ose dokumentet në të cilat mbështetet
8 Prokuroria për këtë argument janë të pabazuara.

9 Ajo çfarë të bën përshtypje është gjithashtu fakti që
10 Prokuroria vazhdon që të injorojë pjesën dërmuese të provave
11 që identifikojnë Bislim Zyrapi si shef të Shtabit
12 Përgjithshëm, që sipas fjalëve të Naim Malokut ishte komanda
13 ose komandanti më i lartë në të gjithë ushtrinë. Për më shumë
14 referencë mund t'i referoheni transkriptit në faqen 26022-
15 26023.

16 Më lejoni të shpjegoj se çfarë dua të them kur them për
17 pjesën dërmuese të provave. Së pari, Zyrapi i është referuar
18 vetes me titullin Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Ne e kemi
19 bërë të qartë në dosjen përfundimtare në paragrafët 581 deri
20 në 582.

21 Së dyti, Zyrapi ka nënshkruar urdhra në cilësinë e tij si
22 shef i Shtabit të Përgjithshëm. Ne këtë referencë e kemi
23 nënvizuar në paragrafin 583 të dosjes përfundimtare, përfshirë
24 këtu dhe provat 624, 628, 630, 631, dhe lista vazhdon me prova
25 të tjera.

1 Së treti, anëtarë të UÇK-së, përshirë këtu dhe ish-
2 oficerë karriere që ishin të informuar për tituj ushtarakë i
3 kanë drejtuar dokumente Zyrapit me titullin e tij si Shefi i
4 Shtabit të Përgjithshëm. Mund ta shikoni këtë në paragrafin
5 584, në provën 1432,1360.

6 Së katërti, ne kemi dëgjuar dëshmitarët në këtë sallë
7 gjyqi që i janë referuar Bislime Zyrapit si Shef i Shtabit të
8 Përgjithshëm. Këtë e japim në më tepër hollësi në paragrafin
9 585, këtu përfshihen ndër të tjerë, Naim Maloku, Sokol
10 Bashota, Rrustem Mustafa, Dëshmitari 4764, 4739, 3871, 3870,
11 Halil Qadraku dhe Kurtesh Fondaj.

12 Kur thotë se Zyrapit ishte vartës i z. Krasniqi,
13 Prokurori, Prokuroria ju kërkon që ta rrëzoni këtë trup
14 provash ose këtë pjesë dërmuese provash, përshirë këtu dhe
15 nëntë dëshmitarë të prokurorëve dhe një pjesë të mirë të
16 dëshmisë së vetë Zyrapit. Kjo sipas nesh është e
17 përealizueshme.

18 Në një ushtri jokonvencionalonale si UÇK-ja është edhe më e
19 rëndësishme se si ushtria funksionon në praktikë, sesa të
20 shohësh se cilët kanë qenë titujt formalë. Ne parashtrojmë që
21 provat janë të qarta që Bislime Zyrapit ka qenë personi
22 përgjegjës. Nga dëshmitarët e Shtabit të Përgjithshëm, Naim
23 Maloku ka renditur kompetencat e Bislime Zyrapit dhe ka shtuar
24 gjithashtu që vetëm ai vetë, Bislime Zyrapit dhe Sali Veseli
25 kishte mundësitë dhe aftësitë e nevojshme për të drejtuar

1 Shtabin e Përgjithshëm. Ndërkohë që personat e tjerë nuk
2 kishin trajtimin e nevojshëm. Sipas tij, pozicioni që kishte
3 z. Krasniqi ishte pozicion dytësor që ai e lidhi me
4 formalizime.

5 Po ashtu, edhe Sokol Bashota vetë ka dhënë dëshmi duke
6 thënë që urdhrat për zonat ishin kompetencë ekskluzive e
7 Bislim Zyrarit, që kishte autoritet të plotë të nxirrte urdhra
8 pa pyetur askënd, pa u konsultuar me askënd në Shtabin e
9 Përgjithshëm. Dhe Sokol Bashota e konfirmon që pozicioni i
10 Jakup Krasniqit nuk njihej fare nga komandantët e zonave. Këtë
11 e kemi trajtuar në më tepër hollësi në paragrafin 612 të
12 dosjes tonë.

13 Kemi dëgjuar gjithashtu dëshmitë e tre komandantëve të
14 zonave.

15 Sylejman Selimi dha dëshmi përpara jush duke thënë që i
16 vetmi person që ka nxjerrë urdhra si komandant zone ishte
17 Bislim Zyrapit, dhe nga ana tjetër, që Jakup Krasniqi
18 kundërshtojë fort si zëvendëskomandant për mbështetje. Jepet
19 më konkretisht ky informacion në faqet e transkriptit 25060,
20 2533.

21 Rrustem Mustafaj dha dëshmi duke thënë që kërkesat e
22 rekomandimet e marra gjatë luftës i kishte marrë prej Zyrapit,
23 si Shef i Shtabit. Ai asnjëherë nuk tha që kishte marrë urdhra
24 nga z. Krasniqi si zëvendëskomandant për mbështetje ose nga
25 komandantët e zonave. Këtë mund ta gjeni më qartë në

1 transkript në faqen 5833, 5834.

2 Gjithashtu, Shukri Buja dëshmoi që pas emërimit të tij si
3 komandant zone, ai ka marrë udhëzime vetëm nga Azem Syla dhe
4 Zyrapit.

5 Kemi dëgjuar gjithashtu dëshmi nga dëshmitarë të tjerë që
6 kanë ngritur të njëjtat argumente që ata i kanë raportuar
7 Bislam Zyrapit dhe jo Jakup Krasniqit. Për shembull, disa prej
8 këtyre persona janë Kurtesh Fondaj, 4871 e të tjerë.

9 Pavarësisht dëshmisë që i ka shërbyer vetes, Bislam
10 Zyrapit që prej fillimit ka qenë i dyshuar prej Prokurorisë,
11 nuk ka asnjë provë të besueshme që Jakup Krasniqi ishte epror
12 i tij. Në të kundërtën Shef i Shtabit të Përgjithshëm ishte
13 vetë z. Zyrapit.

14 Dua të përqendrohem te ky parashtrim për të dëshmuar që
15 jo vetëm dëshmia e z. Zyrapit për z. Krasniqi ishte tërësisht e
16 pabazuar, por demonstroi gjithashtu që parashtrimet e
17 Prokurorisë, si në dosjen përfundimtare dhe të hënën po ashtu,
18 duan të kufizojnë rolin e Zyrapit, duke thënë që ai nuk ishte
19 pjesë e rrethit të brendshëm, ishte i jashtëm. Nuk kishte të
20 njëjtin autoritetet që prej personave që kanë qenë pjesë e
21 UÇK-së që prej fillimit. Dhe në parashtrimet që ky qëndrim
22 është orientues, është i shtrembëruar. Zyrapit ka qenë pjesë e
23 UÇK-së që prej fillimit dhe ka luajtur rol qendror, dhe ne nuk
24 jemi në favor të qëndrimit të Prokurorisë kur thotë që Zyrapit
25 nuk është anëtar i NKP-së.

1 Tani dëshiroj që të kaloj 3 tema shumë shkurtimisht. Së
2 pari, dua që të cek sektorin juridik ose ligjor. Ne e
3 mirëpresim tërheqjen e fjalisë së fundit prej Prokurorisë në
4 paragrafin 567 të dosjes së saj, që është një prej pranimeve
5 të pakta të gabimeve të veta të bëra prej Prokurorisë të
6 hënën. Por, pjesa tjetër e atij paragrafi nuk mjafton, është
7 tërësisht e pamjaftueshme për të provuar që z. Krasniqi ka
8 qenë mbikëqyrës i sektorit juridik.

9 Bislim Zyrapi dëshmoi, kjo është e vërtetë, që Jakup
10 Krasniqi ishte eprori i tij, por Zyrapi nuk është i besueshëm
11 fare. Zyrapi ka vazhduar të jetë i dyshuar gjatë të gjithë
12 intervistës së ZPS-së dhe dëshmisë së tij. Gjatë konfliktit
13 Dobruna është konsultuar me Zyrapin sa i takon ndalimeve,
14 përfshirë këtu edhe për druvarët serbë, apo Blerim Kuqin. Si
15 profesionist i ushtrisë Zyrapi pa diskutim do ketë qenë i
16 informuar lidhur me përgjegjësinë komanduese potenciale. Dhe
17 për këtë arsye ne themi që ai është munduar që të distancohet
18 prej sektorit juridik. Dhe këtë e ka bërë tërësisht për
19 interesa vetjake, për të mbrojtur veten.

20 Ne këtë e parashtruar të premtën, ndërkohë që Prokuroria
21 nuk iu kundërpërgjigj parashtrimin tonë. Zyrapi pranoi që nuk
22 ka pasur asnjë udhëzim prej Jakup Krasniqit për Sokol Dobrunën
23 dhe Sokol Dobruna nuk i ka raportuar Jakup Krasniqit. Kështu
24 që ne nuk e kuptojmë se si dëshmitë apo argumentet e
25 Prokurorisë mund të jenë të qenësishme, në qoftë se nuk

1 mbështetet kontrolli përmes raportimit apo udhëzimeve.

2 Përveç kësaj, qëndrimi i Prokurorisë kundërshtohet
3 tërësisht nga dëshmia e Dobrunës, ku ai thotë që nuk ka pasur
4 asnjë lloj raportimi formal drejt askujt nga Shtabi i
5 Përgjithshëm dhe se askush nuk ka ndërhyrë në punën e tij,
6 përfshirë këtu dhe Jakup Krasniqin. Këtë mund ta gjeni në
7 provat 1955.2, 1955.09 dhe në faqet përkatëse të transkriptit.
8 Më konkretisht 23712.

9 Pika ime e fundit, të nderuar Gjykatës, është kjo që
10 ndërkohë që po përpiquej që të përfshinte ose t'i referohej
11 kontributit të z. Krasniqi për NKP-në e pretenduar, Prokuroria
12 parashtroi të hënën që Jakup Krasniqi ishte pjesë e Shtabit
13 Përgjithshëm. Që të gjithë të akuzuarit ishin pjesë e Shtabit
14 Përgjithshëm. Që ata zgjodhën të vazhdonin të ishin pjesë e
15 Shtabit të Përgjithshëm gjatë kohës kur krimet e pretenduara
16 në aktakuzë kanë vijuar që të realizohen. Pra, pavarësisht
17 kësaj Prokuroria thotë që nuk është nevojshme që t'i ngarkohet
18 përgjegjësi personale secilit prej të akuzuarve. Ky është
19 parashtrimi i të hënës, megjithatë besoj që ju të gjithë e
20 mbani mend që në hapjen, argumentet përmyllëse të
21 Prokurorisë, Prokurorja e Përgjithshme nuk mund të ekishte
22 qenë me e qartë sesa kaq. Ajo parashtroi që "nuk kërkohet
23 vendim fajësimi dhe dënim vetëm mbi bazën e të qenit anëtar i
24 Shtabit të Përgjithshëm ose UÇK-së".

25 Por kjo nuk përkon me atë çfarë parashtroi Prokuroria së

1 fundmi, sipas së cilës vetëm fakti që ishte anëtar i Shtabit të
2 Përgjithshëm ose që zgjodhe që të vazhdosh të jesh anëtar i
3 Shtabit të Përgjithshëm është përcaktuese për përgjegjësinë
4 individuale. Besoj që Trupit Gjykses e di që mund të ketë
5 arsye të ndryshme se pse dikush mund të ketë përzgjedhur që të
6 vazhdojë të qëndrojë në Shtabin e Përgjithshëm kur forcat
7 serbe vazhdonin që të kryenin krime ndaj popullatës civile.

8 I gjithë thelbi i përgjegjësisë personale është që
9 kontributi i secilit prej të akuzuarve duhet të identifikohet
10 individualisht për secilin prej tyre, sepse në qoftë se
11 mjafton që të mbështetesh te anëtarësimi në Shtabin e
12 Përgjithshëm ose çfarë ka bërë Shtabi i Përgjithshëm, atëherë
13 në thelb i takon që çështja është kundër Shtabit të
14 Përgjithshëm, jo kundër akuzuarve individualisht.

15 Të nderuar Gjykatës, të hënën Prokuroria iu kërkoi që të
16 vlerësoni tërësinë e provave. Ne jemi plotësisht dakord me
17 këtë. Ne e dimë që ju, të nderuar Gjykatës, do ta bëni këtë
18 gjë, por ne jemi besimplotë që kur të zbatoni, kur bëni këtë
19 vlerësim, kur të shikoni dokumentet e marra së bashku me
20 dëshmitë e dëshmitarëve dhe kur të zbatoni me rigorozitet
21 parimin e barrës së provës, ju do të pajtoheni me argumentet e
22 parashtruara prej nesh dhe kjo do të çojë në shpalljen të
23 pafajshëm të Jakup Krasniqit prej jush.

24 Faleminderit për vëmendjen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Sikurse e thashë përpara, do bëjmë pushim në 1.30 për
2 drekë, kështu që do bëjnë pushimin e drekës, do fillojmë
3 përsëri në orën 1.30.

4 --- Pauza e drekës fillon në orën 11.30

5 --- Seanca rifillon në orën 13.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani e kanë
7 radhën të akuzuarit të bëjnë deklaratat e tyre. Secili prej të
8 akuzuarve ka 20 minuta për fjalimet e tyre. Deklaratat duhet
9 të trajtojnë vetëm aspekte që janë relevante për këtë proces
10 gjyqësore. Ju lutem të akuzuarve të flasin ngadalë për hir të
11 përkthimit.

12 Do të fillojmë me z. Thaçi.

13 Z. Thaçi, fjala është për ju.

14 I AKUZUARI THAÇI: I nderuar Kryetar i Trupi Gjykses z.
15 Smith, të nderuar Gjyqtarë, të nderuar të gjithë të pranishëm.
16 Përsëritje juve të gjithë që na përcillni nga galeria.

17 Dje në Kosovë u shënuar 18 vjetori i pavarësisë së
18 Republikës së Kosovës. Me 17 shkurt 2008 duke ndjerë rrahjet e
19 zemrave të stërgjyshërve tanë shpallën Kosovën shtet të
20 pavarur dhe sovran e demokratik. Dëshiroj që sot nga kjo sallë
21 të përvojël urimet më të përzemërta të gjithë qytetarëve të
22 Republikës së Kosovë për këtë festë madhështore.

23 Të nderuar Gjyqtarë, për gati tre vite në këtë sallë
24 gjyqi ju i keni dëgjuar akuzat e Prokurorisë dhe argumentet e
25 Mbrojtjes. Ju i keni parë faktet, ju keni dëgjuar të vërtetën.

1 Është vetëm një e vërtetë, që akuzat nuk qëndrojnë. Unë jam
2 plotësisht i pafajshëm.

3 Por e kam thënë dhe e them sërish me bindje të plotë: unë
4 bashkëndej dhe shpreh keqardhje për të gjitha viktimat që
5 kanë pësuar në Kosovë pa marrë parasysh përkatësinë e tyre
6 etnike.

7 Të nderuar Gjyqtarë, në kohën e masakrave në Qirez, në
8 Likoshan, Prekaz, në fillim të vitit 1998, unë isha student në
9 Universitetin e Cyrikut. Unë nuk po bëja plane si ta merrja
10 kontrollin në Kosovë, po bëja plane si t'i përgatitja provimet
11 në universitet.

12 I vetmi njeri që po bënte plane, plane morbide ishte
13 Slobodan Milosheviqi, plane për një gjenocid tjetër, për një
14 gjenocid të ri në Kosovë. Prandaj, si shumë qytetarë të tjerë
15 kosovarë edhe unë më herët u detyrova ta lëshoj Kosovën, sepse
16 regjimi i Milosheviqit më kishte ndjekur. Ai më kishte dënuar
17 në mungesë me akuzën se kisha shkelur ligjet e tij
18 diskriminuese. Më vonë, po i njëjti regjim do të dënojë në
19 mungesë edhe presidentin Clinton edhe Sekretaren Albright edhe
20 Kryeministrin Blair edhe Kancelarin Schroeder edhe Presidentin
21 Chirak edhe Sekretarin e Përgjithshëm të NATOS-s, z. Solana e
22 të tjerë, dënime në mungesë.

23 Prandaj duke i parë masakrat ndaj popullit, tim unë si
24 dhe shumë të tjerë, nuk mund të qëndroja indiferent. Vendosa
25 të kthehem në Kosovë në pranverë 1998. Ky ishte vendim

1 krejtësisht personal i imi i askujt tjetër, sepse nuk mund të
2 qëndroja anash ndërsa familja dhe populli im përballej me
3 shfarosjen. Bëra atë që do të bënte secili prej jush nëse
4 vendi juaj, populli juaj do të përjetonte atë që përjetoi
5 populli im. Për këtë jam shumë krenar dhe nuk i bie pishman
6 asnjëherë.

7 Të nderuar Gjyqtarë, Prokuroria pretendon se qëllimi
8 ishte marrja dhe ushtrimi i kontrollit të Kosovës. Kjo jo
9 vetëm që është plotësisht e pavërtetë, tejet absurde, po është
10 edhe thellësisht ofenduese. Është ofendim për kujtimin e
11 mijëra heronjve që dhanë jetën për liri. Është ofendim për
12 dhjetëra mijëra viktima të pafajshme të vrarë gjatë masakrave.
13 Është ofendim dhe e padrejtë edhe për përpjekjet e NATO-s dhe
14 Aleancës Perëndimore me të cilët unë bashkëpunova ngushtë.

15 Të nderuar Gjyqtarë, më lejoni të përsëris një të vërtetë
16 të përjetshme: I vetmi, apo i bash, i vetmi kundërshtar i imi,
17 i popullit të Kosovës dhe i botës demokratike ishte Slobodan
18 Milosheviqi. Është e rëndë ta dëgjosh këtë akuzë, veçanërisht
19 kur gjatë luftës unë nuk e dija nëse do të isha gjallë prej
20 orës në orë, e prej ditës në ditë. Unë nuk isha i sigurt nëse
21 do të shifsha familjen time, gruan time e djalin e sapolindur,
22 e lëre më të e ëndërroja të ushtroja kontroll në Kosovë, në
23 Kosovën e pushtuar plotësisht për rreth 90 vite. Fakti që disa
24 prej nesh sot jemi gjallë është krejtësisht rastësi dhe fat.

25 Unë nuk u ktheva për të rrezikuar jetën time për kontroll

1 dhe pushtet. U ktheva në atdhe duke rrezikuar jetën time për
2 liri dhe paqe.

3 Pyetja që shtrohet sot është marrja e kontrollit prej
4 kujt? Kush? E vërteta është se kontrolli dhe pushteti ishin
5 plotësisht, ama plotësisht në gjithë territorin e Kosovës në
6 duart e hekurta të Slobodan Milosheviqit. Askujt tjetër.
7 Shqiptarët nuk ushtronin pushtet. Është paradoksale. Ata
8 shtypeshin nga pushteti i Slobodan Milosheviqit.

9 Misioni ynë si popull ishte i qartë, mbijetesa, liria dhe
10 paqja.

11 Unë nuk kisha fare iluzione, por shpresa e jonë e vetme
12 për shpëtim ishte bota demokratike, Shtetet e Bashkuara të
13 Amerikës dhe NATO. Prandaj fokusi im ishte ndërtimi dhe
14 forcimi i kësaj aleance. Për këtë qëllim unë udhëtova në shumë
15 kryeqytete për t'i bindur për kauzën tonë të drejtë në
16 Bruksel, Londër, Berlin, Paris, Bern, Oslo Vjenë dhe vende të
17 tjera. Por kudo që isha, isha në kontakt të vazhdueshëm me
18 zyrtarët e administratës amerikane.

19 Milosheviqi e kishte filluar luftën në Kosovë ndërsa ne
20 kosovarët vetëm po vetëmbroheshim. Por luftën mund ta
21 përfundonte vetëm NATO, askush tjetër, dhe ashtu ndodhi. Po të
22 mos ishte intervenimi i NATO-s, liri të Kosovës nuk do të
23 kishte, nuk do të kishte as pavarësi të Kosovës. Prandaj
24 pavarësia nuk ishte instrument për të marrë pushtet, por për
25 dinjitet.

1 Të nderuar Gjyqtarë, kjo Prokurori më thuri shumë lavde,
2 e më ndau shumë tituj e grada, por e vërteta është krejt
3 tjetër. Unë nuk isha ai i cili transportova rezistencën nga
4 perëndimi në Kosovë. Unë iu bashkova rezistencës në Kosovë.
5 Nuk ishte kthimi im nga perëndimi arsyeja pse UÇK-ja po
6 masivizohej. Arsyeja ishte Slobodan Milosheviqi dhe askush ma
7 bukur nuk e ka thënë sesa Sekretarja e Shtetit Madeleine
8 Albright, citoj:

9 "Milosheviqi me sjelljet e tij ndaj popullit të Kosovës
10 është rekrutuesi më i madh i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës."

11 UÇK-ja nuk ishte shteti, nuk ishte ushtri e një shteti.
12 Ai ishte organizim popullor që po mbrohej nga një shtet
13 agresor. Fakti që UÇK-ja nuk ishte organizuar ashtu siç
14 pretendon Prokuroria se ishte, nuk e zbeh aspak rolin e saj
15 për lirinë e Kosovës. Nuk e bën kauzën e saj për çlirim më pak
16 fisnike e as arritjen e pavarësisë më pak historike.

17 Fitorja e Kosovës ishte më shumë politike dhe
18 diplomatike. Suksesi më i madh i popullit të Kosovës ishte
19 bashkëpunimi i plotë dhe besimi me Perëndimin. Ata na ndihmuan
20 pikërisht, pikërisht sepse e dinin se kush ishim dhe çfarë
21 qëllimi kishim. Unë me asnjë çmim, në asnjë rrethanë, nuk do
22 të rrezikoja këtë aleancë me asgjë në këtë botë, sepse ashtu
23 do të rrezikoja vetë lirinë e Kosovës, do të rrezikoja
24 ekzistencën tonë kolektive. Synimi ynë ishte paqja, nuk ishte
25 lufta.

1 Kur bota demokratike vendosi të thërrasë konferencën e
2 paqes në Rambuje, ne ju përgjigjëm pozitivisht ftesës së tyre.
3 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një nga tri grupet
4 përfaqësuese të Kosovës në këtë konferencë dhe përfaqësuesit e
5 pavarur të tjerë. Megjithatë gjatë gjithë procesit në Rambuje
6 dhe Paris ne punuam si delegacion i Kosovës. Pranuan
7 marrëveshjen e paqes edhe pse ajo nuk i plotësonte të gjitha
8 kërkesat legjitime. Por Kosova zgjodhi paqen dhe demokracinë.
9 Serbia zgjodhi luftën dhe gjenocidin.

10 Për të ndihmuar bashkësinë ndërkombëtare ashtu siç na
11 ishte kërkuar nga perëndimorët, të tri grupet - Lidhja
12 Demokratike e Kosovës, UÇK-ja dhe LBD-ja - u pajtuan për
13 formimin e një qeverie të përbashkët që do të funksiononte
14 deri në zgjedhjet e para të lira demokratike në Kosovë. Ishte
15 marrëveshje për t'i bashkuar forcat dhe energjitë për një
16 qëllim të përbashkët: lirinë e Kosovës.

17 Sot si mundet dikush të pretendojë se qëllimi ishte
18 marrja e kontrollit të Kosovës, kur ne pranuan që bashkësia
19 ndërkombëtare ta kishte fjalën kryesore në Kosovë pastaj që
20 UÇK-ja t'ia dorëzonte armët NATO-Selimi, siç ndodhi më vonë në
21 qershor 1999 - shtator 1999. Pas kapitullimit të Miloshoviçit
22 Kosova fut në administrimin e organizatës së Kombeve të
23 Bashkuara. Fakt i njohur botërisht.

24 UMNİK sqaroi që në fillim se e gjithë pushteti ekzekutiv,
25 legjislativ dhe ai gjyqësor ishte në duart e tyre. Këto ishin

1 rrethana krejt të tjera. Më pas unë punova me UNMIK-un dhe me
2 partitë e tjera politike për të ndihmuar në zbatimin e
3 mandatit në të mirë të popullit të Kosovës. Punova me
4 strukturat e përbashkëta të UNMIK-ut.

5 Të nderuar Gjyqtarë, gjatë tërë kësaj kohe, i vetmi
6 pushtet që kisha unë ishte pushteti i zërit tim. Dhe të
7 nderuar Gjyqtarë, siç e keni parë gjatë procesit gjyqësor, unë
8 e përdora zërin tim për të promovuar një shoqëri shumëetnike,
9 tolerante në vendin tim në Kosovë. Unë u bëra thirrje serbëve
10 lokalë që të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe të ndërtojnë një
11 jetë të re së bashku me ne. Edhe ata, pra serbët dhe
12 komunitete të tjera, sikurse edhe ne ishin viktimat të
13 Milosheviqit.

14 Nuk ishte aspak e lehtë ta bëje këtë pas tërë asaj çka
15 kishte ndodhur, por ishte gjëja më e drejtë dhe më e duhur që
16 mund të bëja. Kur në Kosovë po hapeshin varre gjithandej për
17 mijëra viktimat, mijëra të zhdukur nuk gjendeshin, mijëra
18 pengje shqiptare ishin marrë me vete në Serbi, dhimbja ishte e
19 thellë dhe kolektive, ajo që mund të bëja, ajo që po bëja mund
20 të kishte dhe pasoja fizike por dhe elektorale. Por, Kosova
21 ishte më e rëndësishme sesa fati im personal.

22 Pas hyrjes së NATO-s në Kosovë dhe largimit të forcave
23 serbe, qytetarët e Kosovës nuk po luftonin, ata po festonin
24 lirinë e shumëpritur.

25 Gjatë nëntë viteve të para pavarësisë, do të thotë 1999-

1 2008 ne ishim qytetarë të OKB-së në vendin tonë. Gjatë kësaj
2 kohe unë i bëra thirrje popullatës të kishte durim, të ishin
3 tolerantë, të bashkuar dhe të kishin besim te partnerët
4 ndërkombëtarë. Pavarësia ishte fryt i aleancës tonë me botën
5 demokratike. Pas pavarësisë, punova me Bashkimin Evropian, me
6 SHBA, me faktorë të tjerë relevant për normalizimin e
7 raporteve me Serbinë.

8 Të nderuar Gjyqtarë, ajo me të cilën u përballëm nuk
9 ishte vetëm periudha e luftës. Ishte një shekull shtypje dhe
10 aparteid. Traumata kolektive shkaktuan edhe ndjenjën e fortë e
11 zemërimit dhe hakmarrjes, gjatë dhe pas luftës. Presidenti
12 Clinton erdhi në Kosovë menjëherë pas lufte dhe na tha: Ne e
13 fituam luftën, ndërsa ju duhet ta fitoni paqen. Unë e mora
14 këtë mesazh shumë seriozisht. E përdora zërin tim për të bërë
15 thirrje për paqe, tolerancë dhe unitet.

16 Gjatë pjesës më të madhe pas luftës deri në shpalljen e
17 pavarësisë unë nuk isha në pushtet, isha jashtë pushtetit.
18 Edhe kur edha në pushtet, kam ardh me fitore elektorale. Por
19 gjatë tërë kohës unë respektova normat demokratike dhe
20 rezultatet e zgjedhjeve. Dhe kurdo që partia ime ishte në
21 pushtet, ishte gjithmonë në koalicion me Lidhjen Demokratike
22 të Kosovës dhe parti të tjera politike shqiptare dhe
23 joshqiptare. Së bashku e bëmë shtetin, Kosovën shtet realitet.

24 Por, të nderuar Gjykatës, propaganda ruse dhe serbe nuk
25 do të na falnin lehtë. Pasi dështuan ta delegjitimojnë

1 pavarësinë e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë
2 këtu në Hagë, ata ia mësynë Këshillit të Evropës. Ringjallën
3 pretendimet e tmerrshme për trafikim organesh, pretendime këto
4 që ishin hetuar edhe më parë nga Tribunali i Hagës, nga UNMIK-
5 u dhe EULEX-i, dhe ishin hedhur poshtë si të pabaza.

6 Sapo u publikua raporti i Dick Marty, si kryeministër i
7 Kosovës në atë kohë mblodha përfaqësuesit kryesorë
8 ndërkombëtarë, ambasadorët e *Quint*-it në Kosovë dhe
9 udhëheqësit e EULEX-it. Kërkova dhe një tjetër hetim të
10 pavarur. Ata premtuan se do ta heqin renë e zezë mbi Kosovën.
11 E vërteta është që propaganda ruse dhe serbe manipuloi Dick
12 Martyn. Ai ra viktimë e fushatës së tyre. ata e ushqyen me
13 informacionet e rreme dhe në fund tentuan edhe ta vrisnin për
14 të na fajësuar neve. Qëllimi ishte shumë i qartë: të
15 diskreditohej projekti më i suksesshëm politik dhe ushtarak
16 ndërkombëtar në dekadat e fundit, stوريا e suksesit të
17 Kosovës.

18 Kur votuam në parlament në parlamentin e Kosovës për
19 themelimin e kësaj gjykate, ne besuam se ajo do t'i trajtonte
20 akuzat në raportin e Dick Marty dhe do të vepronte në
21 përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.
22 Në praktikë asnjëherë as tjetra nuk ndodhi.

23 Unë jam kritikuar shumë dhe kritikohem ende në Kosovë pse
24 e mbështetëm themelimin e kësaj gjykate. Kritikët thonë se kjo
25 gjykatë synon kriminalizimin e luftës sonë për liri dhe idenë

1 e pavarësisë. Këtë nuk e kam besuar në atë kohë kur e votuam,
2 por uroj sinqerisht që koha të dëshmojë që unë kisha të
3 drejtë, e kritikët e kishin gabim.

4 Kjo Prokurori në vend që të heqë renë e zezë Kosovës,
5 kërkon t'ia zgjedhë diellin me një stuhi të zezë të ashtu
6 quajturën ndërmarrje e përbashkët kriminale.

7 Shumë nga akuzat që kam dëgjuar nga kjo Prokurori, të
8 nderuar Gjyqtarë, në këtë sallë i kam dëgjuar dhe gjatë
9 fushatave zgjedhore në Kosovë, ama janë bash të njëjta. Është
10 e vërtetë e dhimbshme që kjo Prokurori përpigjet t'i hedhë
11 poshtë dëshmitë e zyrtarët e lartë të NATO-Selimi, Shteteve të
12 Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe OKB-së në këtë
13 gjykatë. Të atyre dhe njerëzve të tyre që ishin tërë kohën
14 bashkë me ne në terren, që ishin sytë dhe veshët e perëndimit
15 nga Kosova.

16 Për më keq, kjo Prokurori pretendon se unë i paskam qitur
17 në lajthitje gjatë gjithë kohës së luftës. Kjo është krejt
18 qesharake. Si duket kjo Prokurori sërish më mbiçmon më tepër
19 seç e meritoj.

20 Nga ana tjetër, kjo Prokurori lartëson në qiell dëshmitë
21 e fabrikuara nga epoka e regjimit të Slobodan Milosheviqit,
22 kështu ajo e injoron edhe vet vërtetën.

23 Të nderuar Gjykatës, krejt në fund --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju ka -- z.
25 Thaçi, keni kaluar kohën që ju ishte caktuar.

1 I AKUZUARI THAÇI: Përkushtimi për drejtësinë dhe viktimat
2 ishte i vazhdueshëm. Në Rambuje unë mbështeta kërkesën që
3 Tribunali për ish-Jugosllavinë t'i hetojë krimet e supozuara
4 nga të gjitha palët, ndërsa nga përfundimi i luftës të gjitha
5 kompetencat për hetimin e krimeve të luftës ishin në duart e
6 ndërkombëtarëve, Tribunalit për -isJugosllavinë, UNMIK-u dhe
7 EULEX-i. Unë e mbështeta punën e tyre. Asnjë i akuzuar në
8 Kosovë për krimin e lufte nuk ishte arratisur dhe madje asnjë
9 xham nuk është thyer për të kundërshtuar procese ligjore gjatë
10 25 viteve të pasluftës.

11 Pas shpalljes së pavarësisë, kur unë isha kryeministër i
12 Kosovës, unë u pajtova që hetimet e pavarur për krime lufte të
13 mbesin në duart EULEX-it. Si president i Kosovës, angazhova
14 ekspertë ndërkombëtarë dhe vendor të të gjitha komuniteteve
15 për të krijuar një forum të drejtësisë tranzicionale për
16 viktimat, Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin. Por e
17 vërteta është se drejtësia për viktimat nuk mund të ndërtohet
18 duke ndjekur të pafajshmit. Pajtimi nuk mund të ndodhë me
19 ndjekje selektive dhe njëetnike.

20 Të nderuar Gjyqtarë, - fjalia e fundit - gjatë gjithë
21 jetës sime unë isha përkrah popullit të Kosovës, në mbrojtje
22 të lirisë jetës dhe dinjitetit njerëzor, gjithmonë duke
23 udhëhequr nga idealet perëndimore të demokracisë, barazisë dhe
24 drejtësisë.

25 Sot në përfundim të këtij procesi e kam vetëm një lutje,

1 të nderuar Gjyqtarë, që vendimi juaj të jetë në përputhshmëri
2 me Kushtetutën e Kosovës ligjet, provat dhe faktet. Dhe provat
3 e paraqitura e bëjnë shumë të qartë se akuzat nuk qëndrojnë,
4 prandaj i vetmi vendim i drejtë është pafajësia e plotë.

5 Ju faleminderit shumë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 z. Thaçi.

8 Z. Veseli, është fjala për ju tani.

9 I AKUZUARI VESELI: Kërkoj falje, ishte gabimi im. Kërkoj
10 falje.

11 Edhe një herë, përshëndetje të gjithë mysafirëve, të
12 cilët janë në sallën e pritjes. Faleminderit shumë.
13 Përshëndetje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

14 I nderuari Kryetari i Trupit Gjykses, të nderuar anëtarë
15 të Trupit Gjykses, në fund të gjykimit tim po ju drejtohem për
16 të theksuar një pikë të vetme, por të jashtëzakonshme prej
17 rëndësie. Gjykata duhet me çdo kusht të mbrojë drejtësinë, të
18 vërtetën dhe paanësinë. Kjo nuk është thjesht një detyrë
19 ligjore. Është kontributi i saj i madh dhe trashëgimia që do
20 të mbetet prej kësaj gjykate.

21 Ky është edhe shkaku pse iu bashkova atyre mijëra grave
22 dhe burrave që u rreshtuan në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës për lirinë e Kosovës dhe pse i kam shërbyer gjithë
24 jetën time vendit tim, që çdo qytetar të gëzojë drejtësi dhe
25 që bota ta njohë të vërtetën për kombin tonë.

1 Edhe në momentet më të errëta nuk e humba kurrë besimin
2 se e drejta, e vërteta dhe liria do të triumfonin. Kam besuar
3 gjithmonë se populli i Kosovës, si çdo popull tjetër në botë,
4 kishte të drejtën e patjetërsueshme për të jetuar në liri dhe
5 me dinjitet. Kam besuar se vuajtjet do të merrnin fund dhe se
6 drejtësia do të vinte, edhe nëse me vonesë.

7 Në të njëjtën kohë, kurrë nuk kam besuar se dhuna,
8 urrejtja apo hakmarrja mund të jenë udhërrëfyes të ndershëm.
9 Ato shkatërrojnë shpirtin e një populli, jo vetëm të viktimës.
10 Urrejtja është vetëm një formë tjetër e robërisë. Liria nuk
11 mund të arrihet përmes padrejtësisë, as paqja nuk mund të
12 ndërtohet mbi krim. Një kauzë e drejtë nuk mund të mbrohet me
13 mjete të padrejta. Ky nuk ka qenë vetëm një parim teorik për
14 mua, por një bindje e thellë morale që ka udhëhequr secilin
15 veprim tim.

16 Familja ime dhe unë kemi jetuar nën persekutim të
17 vazhdueshëm të shtetit serb. Ky nuk është përshkrim abstrakt;
18 është një realitet konkret, i cili e ka prekur secilin anëtar
19 të familjes sime, por edhe mbarë popullin tim. Burrat, gratë,
20 fëmijët, pa përjashtim, përballeshin çdo ditë me padrejtësi,
21 frikë dhe pasiguri. Unë e di çfarë do të thosh të jesh i
22 pambrojtur. E di çfarë do të thosh të jetosh në kërcënim të
23 vazhdueshëm. Kjo është një përvojë që nuk ia dëshiroj askujt,
24 por më mësoi edhe një të vërtetë thelbësore: në padrejtësi
25 njeriu duhet të ruajë integritetin moral dhe vlerat themelore

1 humanes. Disa mund të pyesin, a janë vetëm fjalë këto, apo
2 janë pasqyruar edhe në jetën dhe veprimet e mia? Përgjigja ime
3 sot është e qartë: jo vetëm në fjalët e mia, por mbi të gjitha
4 në provat e paraqitura para kësaj gjykate.

5 Pas dekadash hetimesh, dokumentash dhe dëshmish të
6 panumërta, nuk ka asnjë provë që të tregojë se kam kryer
7 ndonjë krim. Nuk është provuar asnjë veprim i kundërligjshëm
8 nga ana ime. Kjo nuk është çështje interpretimi, kjo është
9 çështje fakti.

10 Sa i përket pjesëmarrjes sime në luftë, ajo nuk ka lindur
11 prej dëshirës sime për konflikt. Si i ri, kam dëshiruar edhe
12 unë një jetë të thjeshtë, të jetoja në vendin tim me dinjitet,
13 në paqe me familjen time. Kam qenë student kur u shfuqizua
14 autonomia e Kosovës dhe universiteti u sulmua prej forcave
15 serbe. Kam marrë pjesë në aktivitete paqësore për mbrojtjen e
16 të drejtave tona themelore.

17 Por, të gjitha këto të drejta na janë mohuar. Autonomia e
18 Kosovës u hoq, ne studentët u përjashtuan nga konviktet dhe
19 fakultetet. Edhe profesorët tanë u përjashtuan të gjithë.
20 Populli ynë u privua prej mundësive më elementare për të
21 jetuar si qytetarë të lirë dhe të barabartë. E vërteta e asaj
22 çfarë po ndodhte tashmë ndihet botërisht. Serbia, edhe
23 Slobodan Milosheviqi, kërkonin kontrollin mbi të gjithë popujt
24 e Jugosllavisë. Kjo tendencë çoi pastaj në epokën e luftërave
25 dhe urrejtjes në ish-Jugosllavi, që çoi drejt shkatërrimit

1 edhe vet të saj.

2 Në fillim të viteve 1990, unë jam larguar prej Kosovës.
3 Ka qenë një largim i detyruar, por edhe një mundësi për një
4 jetë më normale, për një të ardhme të ndërtuar mbi dije dhe
5 përparim. Por ndërsa unë jetoja në një vend të lirë, vendi im
6 po përjetonte vuajtje të thella nën robëri. Gjendja
7 në Kosovë u shndërrua në mohim dhe përjashtim të shumicës.

8 Pas marrëveshjes së Dejtonit, shqiptarët në Kosovë, si
9 shumicë, kanë mbetur fare të përjashtuar. Nuk mund të jetonin
10 lirshëm, por vetëm mbijetonin nën kanosje, kërcënim edhe
11 represion.

12 Në fillim të vitit 1998, unë isha në Universitetin e
13 Freiburgut në Zvicër kur ndodhi masakra e Ali Koshanit. Ishte
14 një tragjedi e rëndë dhe mizori që nuk duhej të kishte ndodhur
15 kurrë në Kosovë. Tragjedia në Prekaz më 5, 6, 7 mars 1998 nuk
16 ka qenë një akt i izoluar, por vazhdim i masakrave të kryera
17 prej forcave serbe. Akte të tilla terrori tejkaluan frikën
18 normale të popullit të thjeshtë dhe drojën e intelektualëve
19 dhe politikanëve në Kosovë. Terrori dhe masakrat, si ato në
20 Srebrenicë, kishin filluar me ndodh edhe në vendin tim, në
21 Kosovë.

22 Nuk mund të qëndroja indiferent ndërsa populli im po
23 përballej me shkatërrim. Për mua, jeta kishte kuptim vetëm
24 nëse populli im mund të jetonte në liri. Prandaj jam kthyer në
25 Kosovë, jo si ushtar i trajnuar, por si një individ ende në

1 studime. Jo me urrejtje, por me bindje. U ktheva sepse ndjeva
2 detyrim moral ndaj vendit tim. U ktheva sepse nuk mund të
3 qëndroja indiferent ndaj vuajtjeve të popullit tim.

4 Synimi im ishte i qartë: të kontribuova për lirinë dhe
5 dinjitetin e popullit tim, por mos t'i bëja askujt padrejtësi.

6 Kam parë këto muajt e fundit në këtë sallë se sa lehtë
7 disa e nënvlerësojnë vështirësinë e ndalimit të një konflikti
8 dhe arritjes së paqes. Por historia na mëson se ata që
9 vendosin paqe shpesh përballen me pasoja. Dhe duke parë
10 realitetin e sotëm, kur bota ka aq shumë nevojë për paqe,
11 është e qartë se ajo nuk arrihet gjithmonë lehtë dhe, për ta
12 ruajtur atë, shpesh është edhe më e vështirë.

13 Të nderuar Trup Gjykses, krijimi i kësaj gjykate dhe
14 funksionimi i saj deri më sot është një rezultat i një debati
15 të gjerë në vendin tim, por mbi të gjitha ajo që duhet të
16 mbizotërojë prej saj është drejtësia dhe paanshmëria në
17 gjykimin e të vërtetës dhe realitetit objektiv, në të cilin
18 kemi vepruar ne.

19 Unë qëndroj në këtë proces me bindje dhe besim se e
20 vërteta nuk ka arsye të ketë frikë nga drejtësia, dhe se
21 drejtësia mund të vonohet, por nuk mohohet kurrë. Kam vepruar
22 me këtë bindje. Kam jetuar me këtë bindje. Sot këtu, para
23 jush, qëndroj me këtë bindje dhe me siguri mund të them: Unë e
24 di kush jam, unë e di çfarë kam bërë dhe çfarë nuk kam bërë.
25 Veprimet e mia kanë qenë njerëzore dhe ligjore. Ndërgjegjja

1 ime është e pastër. Historia ime është transparente. Tani,
2 çdokush mund ta shohë atë edhe në këtë proces gjyqësor.

3 Duke mbyllur fjalën time, i nderuar Trup Gjykues, me
4 respekt për secilin në këtë sallë edhe jashtë saj, edhe pse
5 mund të mos pajtohem, dua të theksoj, ne të gjithë jemi qenie
6 humane me prirje dhe mendime të ndikuara nga ata që na
7 rrethojnë dhe nga ambienti ku jetojmë. Besimi im tek e vërteta
8 dhe drejtësia mbetet i palëkundur, dhe dua të besoj fuqishëm
9 se në vendimin tuaj do të mbisundojë vetëm e vërteta,
10 paanshmëria, drejtësia dhe ligji.

11 I nderuar Trup Gjykues, duke qenë se dje ka qenë dita e
12 pavarësisë së shtetit tim, kam vetëm një përshëndetje në fund
13 për gjithë qytetarët e vendit tim: Urime pavarësia! Ta gëzoni,
14 qytetarët e Republikës së Kosovës, lirinë. Zoti e ndihmoftë
15 Kosovën dhe njerëzit e saj të mirë.

16 Në fund, kam dëshirë të bëj edhe një përshëndetje të
17 veçantë për familjen e një miku tim dhe mbrojtësin, të cilin
18 sot nuk e kemi mes nesh, Andrew Strong. Në të njëjtën kohë,
19 dua të falënderoj edhe ekipin tim mbrojtës për
20 profesionalizmin e tyre dhe sinqeritetin në mbrojtjen time.

21 Ju faleminderit të gjithëve.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 z. Veseli.

24 Z. Selimi, fjala është për ju.

25 I AKUZUARI SELIMI: I nderuar Trup Gjykues, i nderuar

1 Kryetar, të nderuar të pranishëm, më lejoni t'i përshëndes
2 familjen dhe miqtë e mi lart në galeri si dhe gjithë qytetarët
3 e Republikës së Kosovës.

4 Është hera e tretë edhe shpresoj të jetë e fundit që unë
5 e marr fjalën në këtë sallë gjyqi.

6 Kanë kaluar më shumë se pesë vite nga fillimi i këtij
7 procesi gjyqësor. Këto pesë vite nuk kanë qenë të lehta për
8 ne, po as të parëndësishme për historinë e vendit tim.
9 Megjithatë le të shërbejë gjithë kjo si një mundësi dhe shans
10 i mirë për drejtësinë.

11 Pas gjithë këtyre viteve ka edhe një element pozitiv,
12 shpresoj se Trupi Gjyqësor ta ketë pasur kohën e mjaftueshme
13 për ta kuptuar se lufta jonë ishte e drejtë dhe se pretendimet
14 e Prokurorisë nuk qëndrojnë.

15 Në fjalën time në këtë sallë në prill të vitit 2023, kur
16 ky proces sapo kishte filluar, thashë se po përballësia me një
17 aktakuzë të pabazuar. Sot pas gjithë këtij rrugëtimi rrjedha e
18 procesit më ka dhënë të drejtë. Akuzat ndaj nesh janë
19 tërësisht e pabazuara dhe të padrejta.

20 Unë nuk jam ngritur sot këtu ta mbroj veten time, sepse
21 këtë gjë dinë më së miri dhe e kanë bërë avokatët e mi. Nuk
22 jam këtu as për t'ju treguar ju për drejtësinë, sepse ju e
23 dini më mirë se çdokush atë. Unë sot jam këtu për t'u kërkuar
24 nga ju që pikërisht ta ushtroni atë, drejtësinë.

25 Edhe pse kanë kaluar gati tre vite nga fillimi i këtij

1 procesi, Prokuroria ka vazhduar të mbështetet në pretendime që
2 nuk kanë bazë në të vërtetën dhe në një përpjekje të
3 vazhdueshme për të njollosur një luftë që në thelb ishte
4 çlirimtare.

5 Megjithëse Prokuroria që në fillim të paraqitjes së saj,
6 të fjalës përfundimtare, deklaroi se nuk kërkon dënimin e
7 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, gjatë gjithë kohës që pati
8 në dispozicion shënjeshtër e saj ishte pikërisht Shtabi i
9 Përgjithshëm i UÇK-së, Ushtria Çlirimtare dhe në veçanti
10 qëllimi i saj, që ishte pavarësia e Kosovës. Madje krijohej
11 përshtypja sikur vetë pavarësia po trajtohej si një qëllim i
12 përbashkët kriminal.

13 Në përpjekje për ta ngarkuar me përgjithësi -- me
14 përgjegjësi Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së Prokuroria mbajti
15 qëndrime akuzuese si, citoj: "Shtabi i përgjithshëm kërkonte
16 pavarësinë", apo me tutje, "Shtabi i Përgjithshëm deklaroi se
17 nuk do ta mbështeste autonominë".

18 Është e vështirë të kuptohet kundër kujt realisht është
19 ngritur kjo aktakuzë, kundër nesh me veprime, me pretendime
20 për veprime konkrete, apo kundër nesh sepse luftuam për
21 pavarësinë e Kosovës. Kjo mbetet për t'u vlerësuar nga ju, i
22 nderuar Trup Gjykues.

23 Po aq problematike është përpjekja e Prokurorisë për ta
24 ndarë shoqërinë e Kosovës në dysh: në ata që ishin për
25 pavarësi, dhe në ata që ishin për autonomi, sikur të donte që

1 me çdo kusht të krijonte përçarje mes qytetarëve të Republikës
2 së Kosovës.

3 Për ta ilustruar këtë po perifrazoj atë që Prokuroria
4 deklaroi në paraqitjen e provave javën e kaluar. Citoj,
5 "Shtabi i Përgjithshëm kërkonte pavarësinë e Kosovës, partitë
6 politike që mbështesin autonominë konsideroheshin tradhtarë".

7 Të nderuar, në Kosovë nuk ka pasur kurrë asnjë parti
8 politike shqiptare që ishte kundër pavarësisë, dhe
9 rrjedhimisht asnjë që e mbështeste ndonjë autonomi nën Serbi.
10 Të gjitha partitë politike shqiptare ishin për pavarësinë
11 ashtu siç ishte dhe vetë qëllimi i Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës. Ta paraqesësh mbështetjen për pavarësi si kërkesë
13 radikale dhe autonominë si moderne, është një sulm jo vetëm
14 ndaj historisë së Kosovës, por edhe ndaj të ardhmes së saj.

15 Sikur Prokuroria përpiqet të na ndajë ne shqiptarëve mes
16 veti dhe ta barazojë UÇK-në me krimet e Serbisë. Askush nuk
17 mund ta bëjë asnjëherë e as tjetrën. Lufta çlirimtare nuk mund
18 të barazohet me shtetin vrasës të Serbisë.

19 Ta barazosh rezistencën e një populli të shtypur me një
20 plan kriminal do të thotë ta vendosësh në të njëjtin nivel
21 rezistencën e të shtypurit me projektin e shtypësit. Ky
22 barazim nuk është vetëm i pasaktë, por thellësisht i padrejtë.
23 Të përpiqesh të ndërhysh me qëllim në ndryshimin e fakteve
24 historike përmes akuzave me pretendime të shtrembëruara është
25 thjesht të përpiqesh ta rishkruash historinë.

1 E historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet, aq më tepër
2 në një sallë gjyqi. Historinë e Kosovës e kanë shkruar me
3 çmimin e sakrificës qytetarët e saj, luftëtarët e lirisë dhe
4 dëshmorët e atdheut.

5 Kur Serbia dhe Milosheviqi vrisnin moshatarët e mi,
6 helmonin nxënës dhe studentë, i largonin prindërit tanë nga
7 puna, mbyllin shkolla e spitale, na ndiqnin për të na vrarë
8 dhe zbatonin spastrim etnik e gjenocid, çfarë duhej të bënim
9 ne? Të mos reagonim? Serbia kurrë nuk e fshehu qëllimin e saj
10 ndaj shqiptarëve.

11 Në këtë sallë gjyqi dëgjuam dëshminë e Gjeneralit Clark,
12 i cili gjatë një takimi që kishte pasur me kasapin e Ballkanit
13 ai ia kishte deklaruar hapur qëllimet e tij për shqiptarët. Ne
14 dhe gjithë opinioni që e përcillte atë dëshmi, e dëgjuam
15 Gjeneralin e NATO-s teksa tha: "Milosheviqi më tha se 'E dimë
16 se si të sillemi me shqiptarët, duhen vrarë të gjithë'".

17 Edhe ne e dinim këtë, sepse Serbia kurrë nuk e fshihte
18 qëllimin e saj ndaj shqiptarëve.

19 Prandaj pyes sërish: Çfarë duhej të bënim ne? Ta prisnim
20 radhën për t'u vrarë apo të iknim nga vendi dhe shtëpitë tona?
21 Asnjërinë dhe as tjetrën. Prandaj duhej të rezistonim.

22 Prandaj unë besoja se Kosova kishte nevojë për
23 vetëmbrojtje, kishte nevojë për njerëzit të gatshëm ta jepnin
24 edhe jetën për vendin e tyre, kishte nevojë për dikë siç ishte
25 Adem Jashari dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Prandaj unë iu

1 bashkova Adem Jasharit.

2 Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk u krijua nga dëshira por
3 nga nevoja, ishte reagim ndaj dhunës sistematike dhe mohimit
4 të dinjitetit. Nuk ishte aventurë, ishte mbijetesë.

5 Të nderuar, unë isha pjesë e një ushtrie vullnetare, 100%
6 vullnetare e përbërë nga civilë, mësues, studentë, bujq,
7 punëtorë, prindër, njerëz që u detyruan t'i marrin arën sepse
8 nuk kishin rrugë tjetër.

9 Në një pjesë të parashtrimeve të saj Prokuroria në mënyrë
10 të çuditshme dhe në formë akuze më cilëson si një njeri person
11 i afërt me Adem Jasharin dhe si organizator që gëzonte
12 respekt. Nuk është e qartë nëse kjo është menduar si akuzë apo
13 si vlerësim. Për mua të qenit bashkëluftëtar i Adem Jasharit
14 është nderi më i madh që mund ta kisha. Po ashtu konsideroj
15 edhe nder edhe cilësimin si një nga themeluesit kryesorë të
16 UÇK-së. Nëse këto cilësime shndërrohen në akuza atëherë
17 problemi nuk qëndron te unë, por tek ata që i trajtojnë nderin
18 dhe përgjegjësinë historike si faj.

19 Po, kam mbartur armë. Armët për ne ishin mbijetesë, shumë
20 nga bashkëluftëtarët e mi kanë vdekur duke i siguruar ato. Ne
21 kërkuam ndihmë dhe armë edhe nga vendet mike, përfshirë edhe
22 Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që është trajtuar edhe
23 në këtë sallë.

24 UÇK-ja nuk kishte qëllim tjetër përveç lirisë. Nuk kishte
25 plane për të sulmuar civil apo kundërshtarë politikë. Ushtria

1 çlirimtare e Kosovës nuk ishte parti politike, ishte ushtri
2 çlirimtare. Madje edhe nëse lufta në Kosovë nuk do të ndalej
3 në qershor të vitit 1999 dhe do të vazhdonte deri në ditën e
4 sotme, unë ende do të isha ushtar i atdheut tim. Kuptohet nëse
5 nuk do të isha vrarë deri më tani për çka gjasat ishin reale.
6 Jam i bindur se bëmë gjënë e duhur, edhe sot do ta bëja të
7 njëjtën gjë. Liria, paqja dhe demokracia arrihen duke u
8 përballur me agresionin, prandaj edhe NATO na mbështeti,
9 prandaj na mbështetën edhe vendet tuaja.

10 Prokuroria në dosjen e saj përfundimtare kërkon dënime
11 jashtëzakonisht të rënda, aq të gjata sa që në thelb synojnë të
12 na ndalojnë përgjithmonë kthimin në vendin tonë.

13 Koha se do të kthehem në Kosovë tash e tutje varet nga
14 vendimi juaj. Por, Prokuroria duhet ta kishte kuptuar se kurdo
15 që të kthehem unë do të kthehem në Kosovën e lirë, në Kosovën
16 për të cilën jam krenar që i kam dalë zot në kohën më të duhur
17 dhe për lirinë e së cilës kam qenë dhe mbetem i gatshëm ta jap
18 edhe jetën sa herë që do të kërkohej nga unë.

19 Në respekt të secilit prej jush në këtë sallë besoj se po
20 të ishin vendet tuaja në rrethana e njëjta me ato çka ka
21 përjetuar Kosova do të vepronit njësoj. Jam i bindur se dhe ju
22 do të luftonit për njerëzit dhe vendet tuaja, ashtu siç kanë
23 bërë paraardhësit tuaj para se vendet tuaja të bëheshin të
24 lira e demokratike.

25 Gjatë luftës ndodhin shumë gjëra. Ka kaos, frikë, veprime

1 individuale dhe dhimbje të akumuluar nga vitet e tëra me
2 shtypje. Lufta gjithmonë le pasoja dhe viktimat e saj.
3 Pikërisht këto viktimat kanë nevojë për drejtësi të mbështetur
4 mbi të vërtetën sepse drejtësia që nuk mbështetet në të
5 vërtetën i lëndon viktimat për herë të dytë dhe shkatërron
6 vetë qëllimin e saj.

7 Pas gjithë asaj që dëgjuam nga palët gjatë këtyre viteve
8 kërkesa ime është e thjeshtë: që vendimi të mbështetet vetëm
9 në ato që është provuar, jo në ato që është sugjeruar; në
10 fakte, jo në hamendje; në ligje, jo në përshtypje. Jam
11 besimplotë se drejtësia dhe vetëm drejtësia do të na kthejë në
12 atdhe neve që jemi këtu të akuzuar.

13 Në fund, dëshiroj t'i falënderoj ekipet tona të
14 mbrojtjes, dhe në veçanti ekipin tim të udhëhequr nga
15 Geoffrey Roberts për angazhimin profesional në mbrojtjen time,
16 në mbrojtje të së drejtës, dhe mbi të gjitha në mbrojtje të
17 luftës sonë të drejtë.

18 Por, mbi të gjitha i falënderoj bashkëqytetarët tanë që
19 besojnë në pafajësinë tonë, mbështetja e tyre ka bërë që
20 prangat që më kanë rënduar të mos i ndjej si barrë,
21 veçanërisht kur ato pranga tanimë nuk i rëndojnë Kosovës,
22 ashtu siç kanë rënduar gjatë gjithë kohës sa ishte nën
23 pushtimin e egër të Serbisë.

24 Thuhet se njerëzit që bëjnë diçka të mirë për atdheun e
25 tyre janë njerëz me fat. Duket se unë jam njëri prej tyre.

1 Ju faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
3 z. Selimi.

4 Z. Krasniqi, tani është fjala për ju.

5 I AKUZUARI KRASNIQI: I nderuari Kryetar i gjyqit, të
6 nderuar Gjyqtarë, e përmes jush përshëndes po ashtu të gjithë
7 qytetarët e Kosovës që dje e festuan pavarësinë e tyre,
8 qytetarët që jetojnë dhe në liri, në pavarësi dhe me drejtësi.

9 Qëndroj sot këtu para jush, të nderuar qytetarë, jo si
10 një kriminel që përshkruan aktakuza e Prokurorisë, por si një
11 njeri i lindur dhe i kalitur në luftëra, për dinjitet njerëzor
12 nga një popull ose në një popull që e refuzoi që të zhdukej,
13 të zhdukej nga politikat e krimit dhe të gjenocid të Serbisë.

14 Pjesën më të madhe të jetës sime e kam kaluar i udhëhequr
15 nga bindja se qeniet njerëzore meritojnë të jetojnë në liri.
16 Pas më shumë se pesë vitesh burgim të padrejtë - dhe sipas
17 mendimit tim, të panevojshëm -, angazhimin tim politik dhe
18 jetësor për jetë e liri, jam angazhuar që herët, dhe për të
19 dhënë një rrëfim të vërtetë të luftës sonë për pavarësi,
20 kundër politikave të persekutimit dhe të gjenocidit të
21 regjimit serb të cilat sollën vuajtje dhe shkatërrim të paparë
22 për popullin e Kosovës.

23 Për më shumë se pesë vjet, besoj se më janë mohuar të
24 drejtat e njeriut të garantuara nga Konventa Evropiane për të
25 Drejtat e Njeriut dhe liritë themelore. Ndër to, më e

1 rëndësishmja është e drejta për të jetuar në liri, veçanërisht
2 e drejta e një njeriu në fazën e fundit të jetës së tij për të
3 jetuar vitet e mbetura me dinjitet pranë familjes dhe në
4 atdheun e lirë. Kjo me është bërë pa i shkaktuar padrejtësi
5 askujt, pa ia rrezikuar jetën asnjë njeriu të vetëm.
6 Përkundrazi, kam rrezikuar jetën time jo vetëm gjatë luftës
7 çlirimtare, por që nga vitet 1972-1973, së bashku me familjen
8 time, me bashkëkombasit e mi me bashkëfshatarët e mi, me
9 besimin se errësira e padrejtësisë do të thyhej me agimin e
10 shpresës. Kjo është arsyeja pse u angazhova për çlirim dhe
11 barazi për të gjithë. Theksoj veçanërisht periudhën pas 11
12 qershorit të vitit 1998 kur dola hapur me emrin tim të plotë
13 dhe pa maskë si zëdhënës i UÇK-së. Rreziqet ishin të
14 jashtëzakonshme, por nuk u shqetësova për sigurinë time sepse
15 më udhëhiqte përkushtimi im ndaj të gjithë qytetarëve të
16 Kosovës dhe ardhmërisë së tyre.

17 Sot ndodhem në vitin tim të 16 të burgimit, vetëm se
18 luftova për liri, pavarësinë e popullit tim. Thashë në vitin e
19 16, se 10 vite e më tepër burg i kam kaluar nga viti 1981 deri
20 në vitin 1991. Të kesh kaluar 16 nga 75 vitet e jetës në burg
21 dhe të jesh privuar nga ajri i lirisë nuk është diçka e vogël,
22 është diçka e madhe.

23 Dalja ime publike më 11 qershor 1998 tregoi se isha
24 kundërshtar i politikave gjenocidale të Serbisë dhe ndodhi pak
25 kohë pas masakrave serbe në Qirez, Likoshan dhe Prekaz, ku

1 humbën jetën 83 njerëz, shumica prej tyre fëmijë, gra dhe të
2 moshuar të paarmatosur, të vrarë në shtëpitë e tyre. Këto
3 vrasje brutale shënuan një pikë kthese të ndërgjegjes për një
4 brez të tërë shqiptarësh.

5 Çfarë me shtyri të ndërmarr këtë akt jashtëzakonisht të
6 rrezikshëm për atë kohë? Robëria e gjatë, persekutimet,
7 dhunimet, burgimet e shumta dhe ekzekutimet e pandërprera dhe
8 vrasjet që shënuan gjithë shekullin e XX-të. Këto akte mizore
9 nuk me fyen, përkundrazi më bënë të vendosur që drejtësia të
10 mos thyhet mbi shpinën e tiranisë që përjetuam. Dashuria për
11 jetën dhe lirinë më bëri ta marr këtë rol. Një njeri nuk
12 zgjedh lehtë rezistencën, ai e zgjedh atë kur çdo derë tjetër
13 drejt dinjitetit është e mbyllur.

14 Mu mohua dhe mu ndalua e drejta më njerëzore e çdo
15 personi të lindur si i lirë, dhe e çdo njeriu të arsyeshëm që
16 e njeh vlerën e dinjitetin njerëzor dhe barazinë e të
17 gjithëve: e drejta për ta dashur hapur vendin tim, për të
18 punuar për të dhe të përcjell -- dhe për të përcjellë atë që
19 kam mësuar përmes dekadash jete dhe sakrificash. Për këto
20 virtyte u prangosa më 4 nëntor 2020.

21 Akuzat e Prokurorisë kundër nesh dhe UÇK-së janë ndërtuar
22 mbi narrativat e atyre që shkaktuan disa luftëra në gjithë
23 federatën jugosllave brenda një dekade të vetme. Nuk besoj se
24 kjo akuzë i shërben ndonjë drejtësie, e sidomos jo drejtësisë
25 që shoqëritë demokratike pretendojnë ta mbërrijnë. Drejtësia

1 nuk mund të ndërtohet mbi gjuhën e ish-shtypësve. Ajo duhet të
2 qëndrojë mbi prova të besueshme dhe mbi të vërtetën.

3 Padrejtësitë e këtij rasti -- padrejtësia e këtij rasti
4 është e shkruar në vetë aktakuza. Mua më atribuohen role,
5 autoritet dhe përgjegjësi që nuk i kam pasur kurrë. Kjo nuk
6 ishte çështje dallimi në interpretimin e fakteve. Ishte
7 shpifje. Figura e përshkruar në dokumentin e Prokurorisë nuk
8 është njeriu qëndron sot para jush. Jam mirënjohës ndaj atyre
9 dëshmitarëve që erdhën këtu dhe patën guximin ta thonë të
10 vërtetën për atë se kush isha dhe kush nuk kisha. Ata nuk
11 erdhën për të më mbrojtur mua, por për t'i mbrojtur faktet,
12 realitetin tonë historik të Kosovës. Dëshmitë e tyre
13 konfirmuan një realitet të thjeshtë: unë nuk zotëroja
14 pushtetin, komandën apo funksionet që më atribuohen në këtë
15 rast. Kur e vërteta thuhet thjesht, ajo nuk ka nevojë për
16 zbukurime.

17 E gjithë bota e di se NATO-ja ndërhyri kundër krimeve të
18 kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë. NATO-ja edhe bota
19 demokratike nuk janë rreshtuar kurrë me terrorizmin apo
20 gjenocidin. Pa atë ndërhyrje dhe mbështetje ndërkombëtare,
21 liria jonë nuk do të ekzistonte, por pa rezistencën tonë
22 fisnike ajo nuk do të ishte arritur kurrë.

23 Veprimet e UÇK-së dhe veprimet e mia, si gjatë luftës
24 ashtu dhe pas saj, në çdo rast i dhanë përparësi paqes dhe kjo
25 është dëshmuar. Zëra të besueshëm e kanë dëshmuar këtë, ne

1 qëndrojmë sot këtu padrejtësisht por historia do ta kuptojë
2 pse vepruam, jo vetëm faktin se jemi të akuzuar.

3 Duhet të flas për realitetin historik që e rrethon këtë
4 çështje. Krimet dhe persekutimet nga forcat serbe që e
5 formësuan atë periudhë janë të pandashme nga veprimet që ju
6 kërkohet të gjykoni. Ato nuk janë zhurmë në sfond, janë të
7 shkruara në historinë publike me shkronja shumë të mëdha për
8 t'u fshirë. Ato mbeten pjesë e realitetit që ju kërkohet të
9 gjykoni. Bashkohem me avokatët e mi duke ju kërkuar, Gjykatës
10 të nderuar, ta mbani fort në mendje atë histori, sepse gjykimi
11 pa kontekst rrezikon ta ngatërrojë pasojën me shkakun. Ju
12 lutem mos e bëni atë gabim.

13 Lufta jonë nuk ishte unike në histori. Çdo komb kërkuar
14 lirinë nga një pushtim i paligjshëm i ngjashëm me aparteidin
15 është përballur me akuza se rezistenca është kriminale.
16 Megjithatë, e drejta ndërkombëtare pohon se popujt që i
17 rrezikojnë persekutimit sistematik nuk janë armiq të
18 drejtësisë. Ata po vendosin në pah pikërisht parimet mbi të
19 cilat qëndron drejtësia.

20 Brezi ynë i kishte e kishte një vizion: jetën në liri,
21 barazinë, demokracinë, sundimin e ligjit. Ishte ky vizion që
22 udhëhoqi luftën e cila kulmoi me shpalljen e pavarësisë së
23 Kosovës më 17 shkurt 2008.

24 Gjykatës të nderuar, populli ynë kurrë nuk ka kërkuar
25 shkatërrimin e një kombi tjetër, etnie apo feje. Ne luftuam

1 vetëm për jetën, lirinë, demokracinë, barazinë dhe drejtësinë,
2 jo për të kontrolluar territor për dominim, për lakmi apo
3 përfitim kriminal. Qëllimi ynë ishte ta kthenim Kosovën te
4 populli i saj, te i gjithë populli i saj që ata të jetonin me
5 dinjitet siguri dhe me të drejta të barabarta. Çdo akuzë që
6 thotë të kundërtën është vazhdim i gënjeshtreve të prodhuara
7 nga regjimi kriminal i Serbisë.

8 Për të gjithë veprimtarinë time politike, të nderuar
9 Gjyqtarë, vërtet jam krenar. Zëri im qëndronte për lirinë.
10 Bëra atë që besova se e kërkonte fisnikëria njerëzore. Asnjë
11 dëshmitar nuk ka thënë ndryshe. Ju kërkoj t'i shikoni provat
12 dhe dëshmitë në mënyrë objektive dhe aty do të gjeni të
13 vërtetën. Drejtësia nuk i frikësohet shqyrtimit, ajo varet
14 prej tij.

15 Gjykatës të nderuar, e përsëris me respekt edhe një herë,
16 populli ynë kurrë nuk planifikoi shkatërrim apo torturë. Ne
17 kërkonim jetë në liri dhe pavarësi, asgjë më shumë asgjë më
18 pak. Sot populli ynë jeton në liri, nëse dashuria për lirinë
19 gjykohet, si krim atëherë vetë historia do të dënohet.

20 Qëndroj para jush ashtu siç kam qëndruar gjatë gjithë
21 jetës time, i përgjegjshëm ndaj së vërtetës dhe i pafrikësuar
22 prej saj. Ja kushtova jetën time bindjes se njerëzit e
23 meritojnë lirinë. Nëse kjo bindje gjykohet si krim, atëherë
24 historia e vetë do të japë verdiktin e saj shumë kohë pasi kjo
25 Gjykatë të ketë folur. Ju kërkoj ta gjykoni secilën provë me

1 durim dhe pa paragjykim dhe nuk do të gjeni një ndërmarrje
2 kriminale, por një histori njerëzore të formësuar nga shpresa
3 dhe domosdoshmëria, nga besimi në fitore dhe në demokraci.
4 Nëse kjo bindje për lirinë tonë gjykohet drejt këtu, atëherë
5 drejtësia jo që do të më shërbejë mua, por do të nderojë
6 parimin që krijoi këtë gjykatë.

7 Unë këtu po e përfundoj fjalën time duke kërkuar
8 drejtësi, e cila shihet qartë.

9 Faleminderit për vëmendjen tuaj!

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
11 z. Krasniqi.

12 Përpara sesa ta mbyll çështjen gjyqësore, dua që t'ju
13 kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve në qoftë se dëshirojnë që të
14 ngrenë ndonjë çështje tjetër përfundimtare.

15 ZPS-ja?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë çështje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtësi i
18 Viktimave?

19 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Jo.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, nuk kemi çështje
24 tjetër.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa

1 ta përfundoj këtë çështje gjyqësore, dua t'ju kujtoj
2 pjesëmarrësve dhe palëve që, në pajtim me rregullën 136, nuk
3 mund të bëjnë parashtrime të tjera Trupit Gjyqësor në këtë
4 fazë, me përjashtim të rrethanave përjashtimore dhe në qoftë
5 se kërkesat janë të përliggjura. Sigurisht që kjo nuk ka të
6 bëjë me çështje të cilat duhet që të rishikohen në mënyrë të
7 rregullt, si për shembull, ndalimi në paraburgim.

8 Trupi Gjyqësor dëshiron që të falënderojë të gjithë ekipet
9 e Mbrojtjes dhe të gjithë personat të cilët kanë ndihmuar për
10 realizimin e suksesshëm të kësaj çështje gjyqësore. Jemi
11 ndierë shumë të ndihmuar prej kontributeve tona për të
12 siguruar drejtësinë e procesit dhe që ekipet e Mbrojtjes dhe
13 akuzuarit kanë marrë shërbime efektive gjatë të gjithë kohës.

14 Dëshirojnë gjithashtu që të falënderojmë Njësia për
15 Menaxhimin e Gjykatës për punën e tyre të shkëlqyer dhe
16 mbështetjen gjatë gjithë këtij procesi gjyqësor.

17 Gjithashtu i jemi shumë mirënjohës stenografit,
18 përkthyesve dhe të gjithë stafit të Zyrës Administrative për
19 mbështetjen e vazhdueshme.

20 Do të vazhdojmë të jemi në kontakt të vazhdueshëm sipas
21 nevojës me palës sa i takon datës së shpalljes dhe shqiptimit
22 të aktgjykimit.

23 Në përputhje me rregullën 136(1) kjo çështje gjyqësore
24 mbyllet këtu. Seanca përfundon këtu.

25 --- Seanca mbyllet në orën 14.41